

# Vlerësimi i **Ndikimit** **Potencial** të **Gjykatës** **Speciale të Kosovës**

Gëzim Visoka - Shtator 2017

impunity



**PAX**

[www.paxforpeace.nl](http://www.paxforpeace.nl)



# Vlerësimi i Ndikimit Potencial të Gjykatës Speciale të Kosovës

Gëzim Visoka - Shtator 2017

## **Colophon**

Autor: Gëzim Visoka

Foto e ballinës: Njeriu që qëndron para një muri të shkruar me emrat e personave të zhdukur, Prishtinë

Foto krediti: Armend Nimani

Botim nga PAX, Holandë

Utrecht (Holandë), Shtator 2017

## **Falenderimet**

Autori dëshiron të shpreh mirënjohjen për përfitimet e shumta që ky raport ka pasur nga ndihma profesionale dhe komenteve konstruktive të ofruar nga Michael James Warren, Marlies Stappers, Thomas Unger, Kushtrim Koliqi dhe Nena Maksimović. PAX dhe Impunity Watch janë mirënjohëse për kontributin editorial të Susan Clark Translations.

## **Për autorin**

Dr Gëzim Visoka është Profesor Asistent i Studimeve të Paqes dhe Konfliktive në Dublin City University në Irlandë. Ai ka publikuar gjerësisht për Kosovën, drejtësinë tranzicionale dhe për ndërtimin e paqes pas konflikteve. Libri më i ri i Dr Visokës titullohet Formësimi i Paqes në Kosovë: Politika e Ndërtimit të Paqes dhe Shtetësisë *Shaping Peace in Kosovo: The Politics of Peacebuilding and Statehood* (Palgrave Macmillan, 2017).

## **Rreth PAX**

PAX është një organizatë holandeze e shoqërisë civile që tubon njerëz me guximin për t'i dalë zot paqes, duke punuar për të ndërtuar shoqëri dinjitoze, demokratike dhe paqësore anembanë globin. Në Kosovë, programi i PAX përfshin drejtësinë tranzicionale dhe ballafaqimin me të kaluarën, si dhe angazhimin afatgjatë në promovimin e marrëdhënieve të mira mes komuniteteve në veri.

[www.paxforpeace.nl](http://www.paxforpeace.nl) | [info@paxforpeace.nl](mailto:info@paxforpeace.nl)

## **Rreth Impunity Watch**

Impunity Watch është organizatë jofitimprurëse ndërkombëtare e bazuar në Holandë që kërkon të promovojë përgjegjësinë për mizoritë në vendet e dala prej një të kaluarë të dhunshme. IW kryen kërkime mbi shkaqet rrënjësore të mosndëshkimit dhe mbi pengesat për reduktimin e tij, që përfshin zërat e bashkësive të prekura, për të nxjerrë këshilla politikash të bazuara në hulumtime mbi proceset që synojnë të nxisin të vërtetën, drejtësinë, reparacionet dhe mospërsëritjen e dhunës.

[www.impunitywatch.org](http://www.impunitywatch.org) | [info@impunitywatch.org](mailto:info@impunitywatch.org)

# Përmbajtja

<b>Shkurtesat</b>	<b>6</b>
<b>Gjetjet Kryesore</b>	<b>7</b>
<b>Përmbledhja ekzekutive</b>	<b>8</b>
<b>Metodologjia</b>	<b>11</b>
<b>1. Vështrim i shkurtër i iniciativave të drejtësisë tranzicionale në Kosovë</b>	<b>13</b>
<b>2. Kontekstualizimi i krijimit të Gjykatës Speciale të Kosovës</b>	<b>18</b>
<b>3. Vlerësimi i Ndikimit Potencial të Gjykatës Speciale të Kosovës</b>	<b>24</b>
3.1 Identifikimi i ndikimeve potenciale pozitive	24
3.2 Kuptimi i rreziqeve potenciale	28
<b>4. Forcimi i Mundësive për Ndikim Pozitiv dhe Zbutje të Rreziqeve</b>	<b>32</b>
4.1 Nevoja për një qasje pan-shoqërore drejt drejtësisë tranzicionale	32
4.2 Mbyllja e boshllëkut të (keq)perceptimit	34
4.3 Ngritja e bashkëpunimit të hisedarëve vendor	35
4.4 Rigjallërimi i rolit të shoqërisë civile	37
<b>Konkluzionet dhe Rekomandimit</b>	<b>39</b>
<b>Fusnotat</b>	<b>42</b>

# Shkurtesat

KVP	Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin
SHEVJ (ang. EEAS)	Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit në Kosovë
IKSP (ang. IcSP)	Instrument Kontribues në Stabilitet dhe Paqe
TPNJ	Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë
GPNBKP	Grupi Punues Ndërmator për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtim
IAP (ang. IPA)	Instrumenti për Asistencë Para-Antarësimit
KFOR	Forca e Kosovës (NATO)
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PSK	Prokuroria Speciale e Kosovës
PACE	Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës
RECOM	Komision Rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në ish-Jugosllavi
RYCO	Zyra Regjionale për Bashkëpunim Rinor
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
TFSH	Task Forca Speciale Hetuese
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

# Gjetjet Kryesore

- ◆ Dhomat Speciale dhe Prokuroria Speciale e Kosovës (Gjykata Speciale) u krijuan në vitin 2015, pas një presioni të vazhdueshëm ndërkombëtar, për të gjykuar krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit që supozohet se janë kryer nga pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), në mes viteve 1998 dhe 2000.
- ◆ Përtej ofrimit të një mase të drejtësisë për viktimat dhe dhënies fund të pandëshkueshmërisë, Gjykata Speciale e Kosovës mund të ketë ndikim pozitiv shoqëror duke inkurajuar nismat e tjera që kanë të bëjnë me shkaqet e injoruara, faktorët nxitës dhe me trashëgiminë e konfliktit në Kosovë.
- ◆ Megjithatë, konteksti jomiqësor shoqëror dhe politik në Kosovë tregon që Gjykata Speciale, po ashtu, rrezikon të prodhojë efekte të dëmshme, si p.sh. polarizim të mëtejshëm të marrëdhënieve brenda-etnike dhe ndër-etnike, duke minuar stabilitetin politik dhe reformat institucionale, duke vonuar normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe duke dëmtuar kredibilitetin dhe pozitën ndërkombëtare të Kosovës.
- ◆ Këto rreziqe potenciale mund të zbuten nëse Gjykata Speciale, Qeveria e Kosovës dhe komuniteti ndërkombëtar bashkëpunojnë në ofrimin e një programi të plotë dhe inkluziv të kontaktit dhe dialogut publik, i cili trajton keqinformimin dhe kundër-narracionin nacionalist; dhe që ndërmerrë një qasje gjithëpërfshirëse shoqërore ndaj drejtësisëtranzicionale që nënkupton fuqizimin e përpjekjeve të institucioneve vendore në ndjekjen penale të krimeve të luftës përmes gjykatave vendore, duke mbështetur iniciativat e shoqërisë civile që paraprakisht kanë të bëjnë me të kaluarën e luftës dhe duke integruar temat e drejtësisë tranzicionale në procesin e zgjerimit të BE-së dhe dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, të lehtësuar nga BE-ja. ◆

# Përmbledhja ekzekutive

Që nga përfundimi i konfliktit të Kosovës së viteve 1998-99, gjykatat hibride ndërkombëtare dhe vendore kanë qenë forma kryesore për hetimin e krimeve më të rënda dhe krimeve kundër njerëzimit në Kosovë.<sup>1</sup> Krijimi, në vitin 2015, i Dhomave Speciale dhe Prokurorisë Speciale të Kosovës (këtu e tutje 'Gjykata Speciale') përfaqëson përpjekjen e fundit për të gjykuar një grup të caktuar të krimeve të pretenduara, të kryera nga pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), gjatë dhe menjëherë pas konfliktit të dhunshëm. Edhe pse formalisht është pjesë e sistemit ligjor të Kosovës, Gjykata Speciale gëzon autonomi të plotë nga të gjitha institucionet e Kosovës, është e vendosur jashtë Kosovës, në Hagë, dhe financohet nga Bashkimi Evropian (BE). Juridiksioni i Gjykatës Speciale përfshin hetimin e krimeve të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare, të kryera gjatë dhe menjëherë pas konfliktit në Kosovë. Krimet e supozuara që Gjykata Speciale do të gjykojë janë përmendur në një raport të Këshillit të Evropës (i njohur gjerësisht si Raporti i Martit) dhe fillimisht janë hetuar nga një Task Forcë Speciale Hetuese (TFSH). TFSH ka rekomanduar krijimin e një organizmi të veçantë gjyqësor, të vendosur jashtë Kosovës, për të gjykuar siç duhet krimet e supozuara.

Gjersa Gjykata Speciale mund të ofrojë një masë të drejtësisë për viktimat dhe një formë të drejtëpërdrejtë të llogaridhënies për kryesit e supozuar, puna e saj mund të dëmtohet rëndë nga mirëkuptimi i kufizuar publik dhe kontestimet e rëndësishme politike në Kosovë. Bashkësia ndërkombëtare dhe aktorët politikë etnikë serbë e shohin Gjykatën Speciale si një hap pozitiv drejt administrimit të drejtësisë për krimet e pandëshkuara ndaj pakicave në Kosovë, por i gjithë procesi që dërgoi në themelimin dhe funksionalizimin e Gjykatës Speciale, ka ngritur debate të ashpra dhe polarizuese mes politikanëve etnikë shqiptarë dhe publikut të gjerë. Shumë aktorë politikë shqiptarë në Kosovë nuk e mbështesin Gjykatën Speciale për shkak të pakënaqësisë së madhe për faktin se ky mekanizëm përqëndrohen vetëm në krimet e supozuara të UÇK-së, duke injoruar krimet e tjera që nuk janë gjykuar nga mekanizmat e mëparshëm për gjykimin e krimeve të luftës. Kjo përforcohet nga ndarjet e vazhdueshme etnike, mungesa e entuziazmit për pajtim dhe mbizotërimi i mohimit shoqëror në lidhje me disa abuzime në të kaluarën. Qeveria e Kosovës e kanë mbështetur me gjysmë zemre krijimin e Gjykatës Speciale. Sidoqoftë, mbetet të shihet nëse ata do të vazhdojnë të bashkëpunojnë dhe të pajtohen më të, pas ngritjes zyrtare të aktakuzave të para. Kjo, po ashtu, varet edhe nga përbërja e qeverisë së re të Kosovës, pas zgjedhjeve të parakohshme në qershor 2017. Prandaj, ekziston nevoja për të vlerësuar ndikimet e mundshme të Gjykatës Speciale mbi stabilitetin politik dhe pajtimin etnik në Kosovë dhe për të eksploruar mënyrat e zbutjes së efekteve negative që mund të lindin nga mosmarrëveshjet në vend.



Ky studim konstaton se konteksti aktual politik dhe shoqëror në Kosovë do të komplikojë dukshëm punën e Gjykatës Speciale dhe mund të prodhojë efekte pozitive dhe negative. Së pari dhe më kryesorja, Gjykata Speciale pritet të promovojë llogaridhënien për krimet e supozuara të kryera nga aktorët joshitetërorë në Kosovë dhe t'u sigurojë viktimave dhe familjeve të tyre një masë të shumëpritur të drejtësisë. Megjithatë, kjo varet nga performanca e kënaqshme e Gjykatës Speciale dhe nga masat mbështetëse më të gjera të ndërmarra nga shoqëria civile dhe politike në Kosovë. Përveç sigurimit të masës së drejtësisë për viktimat, duke i dhënë fund pandëshkueshmërisë dhe duke sjellë qartësi ligjore në lidhje me krimet e supozuara, Gjykata Speciale mund të krijojë momentum të ri për të fuqizuar përpjekjet vendore, kombëtare dhe përpjekjet më të gjera rajonale që synojnë adresimin e trashëgimisë së konfliktit në mënyrë më gjithëpërfshirëse, duke promovuar pajtimin brenda-etnik dhe ndër-etnik dhe duke larguar elementet ekstremiste nga proceset politike.

Mirëpo, kontestimi politik i krijuar nga puna e Gjykatës Speciale mund të shkaktojë rreziqe potenciale në Kosovë, të cilat mund të dëmtojnë stabilitetin politik, mund të çojnë drejt përkeqësimit të marrëdhënieve etnike, të ndalojnë reformat politike dhe të thellojnë armiqësinë vendore ndaj bashkësisë ndërkombëtare. Gjykata Speciale tashmë është bërë një katalizator që mund të polarizojë edhe më marrëdhëniet brend-aetnike (mes shqiptarëve etnikë) dhe të minojë normalizimin e marrëdhënieve ndër-etnike (mes shqiptarëve etnikë dhe bashkësive serbe) në Kosovë. Përhapja e keqkuptimeve dhe keqinformimit lidhur me mandatin e Gjykatës Speciale, së bashku me dominimin e kundër-narrativave që kundërshtojnë punën e saj, rrezikon të dëmtojë efektet e pritura pozitive shoqërore të Gjykatës. Për shumicën e shqiptarëve të Kosovës, Gjykata Speciale shihet si një organ i politizuar që nuk ka paanësi dhe që synon të theksojë keqbërjet e kryera nga ish-pjesëtarë të UÇK-së, dhe në këtë mënyrë, që përpiket të zhvendosë përgjegjësinë për krimet e luftës nga Serbia në Kosovë. Në anën tjetër, për serbët etnikë, Gjykata Speciale përfaqëson një mundësi për të minuar fuqinë politike të lidershit të afërt me UÇK-në dhe, më pas, për të ndryshuar axhendën e shtet-ndërtimit dhe komb-ndërtimit në Kosovë. Disa të tjerë, po ashtu, frikësohen se Gjykata Speciale do të ndikojë negativisht në reformat e brendshme të Kosovës dhe do të dëmtojë reputacionin e saj ndërkombëtar. Serbia fqinje tashmë ka filluar përdorimin e Gjykatës Speciale për të minimizuar përgjegjësinë e Serbisë për krimet e luftës në Kosovë dhe më gjerë në rajon, me qëllim që të minojë pozitën ndërkombëtare të Kosovës.

E zënë mes këtyre agjendave divergjente etnike, Gjykata Speciale rrezikon të antagonizojë më tej familjet shqiptare (të Kosovës) të viktimave dhe personave të humbur si dhe të dëmtojë besimin, edhe ashtu të brishtë, vendor në drejtësinë penale ndërkombëtare. Për më tepër, politizimi i punës së Gjykatës Speciale mund të ndikojë negativisht në normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si dhe të dëmtojë ndihmën e BE-së për këtë proces të ndjeshëm, por shumë të rëndësishëm.

Derisa Gjykata Speciale synon të kërkojë llogaridhënie nga kryesit e krimeve të supozuara, rreziqet potenciale të këtij procesi mund të zbuten vetëm nëse hisedarët kosovarë dhe ndërkombëtarë ndërmarrin një qasje gjithëpërfshirëse shoqërore drejt drejtësisë tranzicionale dhe drejt ballafaqimit me të kaluarën. Qasja gjithëpërfshirëse për t'u ballafaquar me të kaluarën në Kosovë, nënkupton forcimin e përpjekjeve të institucioneve vendore për të ndjekur penalisht krimet e luftës përmes gjykatave të vendit, duke dyfishuar përpjekjet për të promovuar tregimin gjithëpërfshirës të së vërtetës, përkujtimin qytetar dhe dëmshpërblimin jodiskriminues për të gjitha kategoritë shoqërore, si dhe mbështetjen e nismave lokale për pajtim. Institucionet e

Kosovës duhet të demonstrojnë pjekuri politike, duke bashkëpunuar dhe duke u pajtuar me kërkesat e Gjykatës Speciale, si dhe duke dekurajuar reagimet penguese. Në mënyrë që procesi i ballafaqimit me të kaluarën të ketë sukses në Kosovë, Serbia duhet të ndërmarrë hapa për mbështetjen e iniciativave të drejtësisë tranzicionale vendore, kombëtare dhe, më gjerë, rajonale. Pavarësisht nga roli i pronësisë vendore, roli i BE-së dhe bashkësisë më të gjerë ndërkombëtare është i domosdoshëm.

Po ashtu, grupet e shoqërisë civile, opinion-bërësit dhe mediat mund të luajnë një rol të rëndësishëm, duke marrë një qëndrim konstruktiv, racional dhe empatik për rëndësinë e tregimit të së vërtetës, sjelljen e drejtësisë dhe kërkimin e pajtimit për shoqërinë kosovare. Vetëm nëpërmjet një angazhimi gjithëpërfshirës dhe të përtërirë të të gjithë aktorëve vendorë, rajonalë dhe ndërkombëtarë, mund të zbuten ndikimet e padëshiruara të Gjykatës Speciale si dhe të maksimizohet potenciali i institucionit për të nxitur ndryshime pozitive shoqërore. ♦

# Metodologjia

**K**y studim përpiqet të vlerësojë ndikimin potencial të Dhomave Speciale dhe Prokurorisë Speciale të Kosovës (tani e tutje 'Gjykata Speciale'<sup>2</sup>) në Kosovë. Në përgjithësi, vlerësimi i ndikimit të gjykatave speciale të krimeve të luftës dhe mekanizmave tjerë të drejtësisë penale bëhet pasi që kanë përfunduar gjykimet.

Ky studim përdor një kornizë të zhvilluar nga Impunity Watch për vlerësimin e gjykatave penale ndërkombëtare, që vlerëson shkallën në të cilën mekanizmat dhe proceset e tyre kontribuojnë në të vërtetën, drejtësinë dhe pajtimin, siç definohet si më lart.<sup>3</sup> E vërteta matet me masën në të cilën pohimet, dëshmitë dhe vendimet e gjykatave konsiderohen të besueshme dhe me shkallën në të cilën krimet e pretenduara pranohen ose mohohen nga publiku i gjerë. Drejtësia matet nga perceptimi publik i gjykimeve, njohja e punës së gjykatave të krimeve të luftës dhe kuptimi më i gjerë i drejtësisë. Pajtimi matet me sigurinë njerëzore, kontaktin ndëretnik, besimin dhe pranimin reciprok. Përgjatë kësaj fushe, studimet e vlerësimit të ndikimit kanë konstatuar se masat e drejtësisë penale zakonisht prodhojnë “pasoja të shumëfishta, kundërthënëse dhe shpesh të papritura”.<sup>4</sup> Këto efekte mund të luajnë një rol pozitiv shoqëror, për shembull, duke kontribuar në pajtimin etnik, duke lehtësuar shërimin psikologjik, duke ushqyer të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit, duke parandaluar incidente armiqësore dhe duke parandaluar konfliktet e ardhshme. Megjithatë, kjo përjashton mundësinë e masave të tilla të drejtësisë penale që përkeqësojnë ndarjet etnike, duke minuar stabilitetin politik dhe duke minuar përpjekjet lokale për paqe, drejtësi dhe pajtim.<sup>5</sup> Meqenëse Gjykata Speciale nuk ka filluar ende procedurat gjyqësore, performanca dhe efikasiteti i saj mbetet i panjohur. Megjithatë, një analizë gjithëpërfshirëse e kontekstit shoqëror dhe politik si dhe pozicionet e aktorëve kryesorë mund të ofrojnë një bazë të dobishme për të eksploruar ndikimin e mundshëm shoqëror të Gjykatës Speciale dhe për hartimin e strategjive zbutëse. Në këtë fazë të hershme, vëzhgimet rreth ndikimit të Gjykatës Speciale janë parashikime me themel empirik dhe parashikime të stërholluara.

Në vlerësimin e ndikimeve pozitive dhe negative të Gjykatës Speciale, ky studim ofron së pari një pasqyrë të kontekstit social dhe politik, brenda të cilit institucionet do të veprojnë; përmbledhja përfshin një skicë të trashëgimisë së proceseve të mëparshme të drejtësisë tranzicionale në Kosovë.<sup>6</sup>

Në lidhje me arritjet dhe mangësitë e gjyqeve të krimeve të luftës si dhe iniciativave të tjera të drejtësisë tranzicionale në Kosovë, ofrohet një analizë dokumentare. Studimi pastaj ofron një pasqyrë të plotë të fazave kyçe dhe pengesave politike dhe ligjore përpara se të krijohet Gjykata Speciale për të ilustruar kushtet sfiduese të sfondit dhe vështirësitë e mundshme që mund të përjetojnë në të ardhmen.

Ky studimi ofron një vështrim gjithëpërfshirës mbi ndikimet e mundshme pozitive të Gjykatës Speciale në shoqëri. Ai gjithashtu shqyrton rreziqet e mundshme dhe strategjitë e mundshme

të zbutjes së rreziqeve. Ky segment kryesor i studimit bazohet në informacionet e nxjerra nga rishikimi i dokumenteve dhe hulumtimit në terren në Kosovë, Bruksel dhe Hagë, gjatë muajve prill dhe maj 2017. Janë zhvilluar mbi 40 intervista dhe biseda me bashkëbiseduesit nga Qeveria e Kosovës, Gjykata Speciale, Komisioni Evropian dhe Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm, aktorët e shoqërisë civile nga të gjitha përkatësitë etnike dhe grupe të tjera relevante të interesit dhe komentatorë politikë. Intervistat dhe bisedat kanë synuar të kuptojnë pikëpamjet e pjesëmarrësve mbi origjinën, krijimin dhe ndikimin e mundshëm të Gjykatës Speciale.

Për shkak të natyrës së ndjeshme të Gjykatës Speciale, gjatë mbledhjes së të dhënave për këtë studim, janë hasur disa vështirësi. Ato përfshinin hezitimin midis hisedarëve vendorë dhe ndërkombëtarë për ndarjen e pikëpamjeve të tyre, një sekuritizim dominues të njohurive mbi strategjinë e prokurorisë dhe të qasshmërisë të Gjykatës Speciale, si dhe përhapjen e dukshme të informatave anekdotike, përsëritjen e pikave dhe njohurive të vogla substanciale në mesin e të intervistuarve. Një nivel i panevojshëm dhe kundërproduktiv i dyshimit duket se ekziston brenda Gjykatës Speciale. Kjo u artikulua me mungesë të transparencës dhe refuzimit të zbulimit të informacionit të dobishëm për publikun, shoqëruar me kujdes të jashtëzakonshëm dhe mosbesim ndaj kërkuesve dhe shoqërisë civile. Meqenëse ky studim është vlerësimi i parë gjithëpërfshirës i pavarur i ndikimit të mundshëm të Gjykatës Speciale, një mungesë e tillë angazhimi përfaqëson një mundësi të humbur për të arritur tek një audiencë më e gjerë, për të menaxhuar pritjet dhe për të ndrequr keqkuptimet. Ngjashëm, hisedarët kryesorë ndërkombëtarë, të cilët kanë nxitur për themelimin e Gjykatës Speciale, shprehën një mosgatishmëri për të diskutuar për Gjykatën Speciale duke u përpjekur që të largohen nga përgjegjësia për rezultatet e mundshme të këtij procesi të ndjeshëm të drejtësisë penale. Përkundër këtyre kufizimeve të papritura, ky studim ka arritur të mbledhë një masë të fortë provash, nga e cila mund të përfitojnë palët e interesuara dhe publiku i gjerë. ♦

# 1. Vështrim i shkurtër i iniciativave të drejtësisë tranzicionale në Kosovë

**K**onflikti i Kosovës ishte kapitulli i fundit në shpërbërjen e dhunshme të ish-Jugosllavisë, e cila u karakterizua nga një numër i madh viktimash, krime lufte shkatërruese, spastrim etnik dhe ndërhyrje ushtarake ndërkombëtare.

Numri i viktimave në konfliktin e Kosovës vlerësohet të jetë 13,535, nga të cilët 10,812 (80 për qind) ishin pjesëtarë të shumicës etnike shqiptare, 2,197 (16 për qind) ishin pjesëtarë të pakicës etnike serbe, dhe 526 (4 për qind) ishin romë, boshnjakë dhe pjesëtarë të komuniteteve tjera pakicë në Kosovë.<sup>7</sup> Shumica dërmuese e viktimave u vranë nga ushtria serbe, policia dhe forcat paraushtarake në një fushatë të spastrimit etnik të orkestruar nga shteti, që synonte gjithashtu të shtypte grupet e rezistencës paqësore dhe të armatosura që kërkonin vetëvendosje dhe shtetësi të pavarur.<sup>8</sup> Për më tepër, mbi 1,600 persona nga të gjitha grupet etnike në Kosovë u zhdukën ose u rrëmbyen dhe ende janë të pagjetur. Shumica e këtyre veprave penale përbëjnë krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, të cilat janë të ndaluara sipas të drejtës ndërkombëtare penale, sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe sipas ligjit të konflikteve të armatosura. Derisa shumica e viktimave etnike shqiptare ishin civilë, rreth 45 për qind e viktimave etnike serbe ishin ushtarakë dhe policë. Në periudhën menjëherë pas konfliktit të armatosur, shumica e viktimave ishin civilë nga komunitetet e pakicave etnike, të cilat ishin viktimat të akteve të hakmarrjes etnike dhe të akteve të organizuara të plaçkitjes së pasurisë.

Kjo trashëgimi e konfliktit vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në formësimin e paqes në

Kosovë dhe ndikon negativisht në pajtim etnik.<sup>9</sup> Mungesa e një marrëveshjeje paqësore midis Kosovës dhe Serbisë në fund të konfliktit, ka rezultuar me aplikimin e mekanizmave ad hoc të drejtësisë tranzicionale, të imponuara nga jashtë dhe që ishin gjerësisht të papëlqyeshëm.<sup>10</sup> Armiqësitë që kanë zgjatur me dekada midis shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë, kanë lënë një mosbesim të thellë të gjykatave të njëanshme etnike të bazuara në Serbi apo Kosovë.<sup>11</sup> Qasja e bashkësisë ndërkombëtare drejt drejtësisë tranzicionale në ish-Jugosllavi është përqendruar në drejtësinë penale të zbatuar nëpërmjet Tribunalit Ndërkombëtar Penal të Kombeve të Bashkuara për ish-Jugosllavinë (Tribunali i Hagës) dhe gjykatave të brendshme hibride. Gjykatat ndërkombëtare dhe hibride e ndjekin dënimin penal si një proces të nevojshëm ndëshkues për sanksionimin e kryesve individuale për shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare, për t'u shërbyer nevojave të viktimave, për të fuqizuar normat demokratike dhe për të zvogëluar kërcënimet politike si dhe për të penguar abuzuesit potencialë të menjëhershëm dhe të ardhshëm.<sup>12</sup> Megjithatë, fokusi i bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë për drejtësinë penale ishte në dëm të qasjeve të tjera të drejtësisë tranzicionale, që mund të ndihmonin vendin të trajtonte në mënyrë gjithëpërfshirëse trashëgiminë e dhunës në të kaluarën.<sup>13</sup>

Gjatë 24 viteve të funksionimit, juridiksioni i Tribunalit të Hagës ka mbuluar të gjithë territorin e ish-Jugosllavisë gjatë periudhave të konfliktit të armatosur. TPNJ ka arritur të padisë vetëm 161 individë për krime lufte dhe shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare në gjithë hapësirën e ish-Jugosllavisë.<sup>14</sup> Sa i përket konfliktit në Kosovë, Tribunali i Hagës u përqëndrua kryesisht në "udhëheqës të nivelit të lartë civil, policor dhe ushtarak, të cilësdo palë në konflikt, i cili mund të jetë përgjegjës për krimet e kryera gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë".<sup>15</sup> Ndërmjet viteve 1999 dhe 2017, Tribunali i Hagës ka paditur dhe ka gjykuar një numër të vogël të zyrtarëve të lartë ushtarakë dhe politikë serbë për krimet e luftës në Kosovë, duke përfshirë ish-presidentin, kryeministrin dhe ministrat, si dhe udhëheqjen kryesore ushtarake, të sigurisë dhe të inteligjencës. Sa u shqiptarëve etnikë, Tribunali i Hagës shqyrtoi dy raste të profilit të lartë kundër dy komandantëve rajonal të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Ramush Haradinajn dhe Fatmir Limajt (dhe bashkëpunëtorët e tyre), dhe që të dy u liruan.<sup>16</sup> Tribunali i Hagës erdhi në përfundim se shkalla dhe shpeshtësia e krimeve të pretenduara të kryera nga UÇK-ja nuk përbënte krim kundër njerëzimit dhe nuk u gjetën baza për koordinim të përbashkët dhe bashkëpunim në kryerjen e krimeve masive të luftës.<sup>17</sup> Efektiviteti i Tribunalit i Hagës u dëmtua nga gjykimet e zgjatura, apelet dhe rigjykimet, bashkëpunimi i kufizuar nga autoritetet shtetërore, problemet me mbrojtjen e dëshmitarëve dhe vështirësitë në mbajtjen e të akuzuarit në paraburgim.<sup>18</sup> Ndërsa Tribunali i Hagës po i jep fund mandatit të saj që gëzon njohje të fuqishme globale për të pasur drejtësi penale të avancuar ndërkombëtare, trashëgimia e saj në Ballkanin Perëndimor mbetet e kontestuar për shkak se komunitetet etnike mbeten të polarizuara, viktimat janë të pakënaqura dhe shumë keqbërës mbeten të lirë.<sup>19</sup> Ndërsa shqiptarët në Kosovë konsiderojnë se Tribunali i Hagës nuk ka akuzuar mjaft serbë për krime lufte, ky tribunal perceptohet nga serbët në përgjithësi si një mekanizëm anti-serb.

Paralelisht me Tribunalin e Hagës, Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) administroi gjykatat e brendshme hibride në Kosovë, të cilat merreshin me hetime të profilit të ulët të krimeve të luftës dhe ofruan asistencë brenda vendit për Tribunalin e Hagës.<sup>20</sup> Në vitin 2000, UNMIK-u mori përsipër administrimin e hetimeve të krimeve të luftës, duke u frikësuar se hetimet e njëanshme të institucioneve gjyqësore vendase do të kishin pasoja në stabilitetin e brishtë gjatë tranzicionit pas konfliktit. Duke u përqendruar në përpjekjet për ndërtimin e paqes dhe ndërtimin e shtetit, performanca e UNMIK-ut për drejtësinë tranzicionale konsiderohet e varfër dhe ajo arriti të përfundojë vetëm rreth 40 raste

të krimeve të luftës.<sup>21</sup> Raportet e monitorimit nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) zbuluan se UNMIK-u demonstroi dështime sistematike në gjykimin e rasteve të krimeve të luftës, siç duket qartë në vonesat në trajtimin e rasteve, mungesën e vazhdimësisë në personelin gjyqësor, mungesën e trajnimeve dhe kapaciteteve që merreshin me rastet e krimeve të luftës dhe mbrojtjen e pamjaftueshme të dëshmitarëve dhe gjyqtarëve.<sup>22</sup> UNMIK-u gjithashtu është kritikuar për menaxhimin e dobët dhe arkivimin e dëshmive të krimeve të luftës. Në një masë të madhe, mangësitë e UNMIK-ut ishin rezultat i kushteve të pafavorshme vendore, të tilla si ndërhyrja politike në rastet e krimeve të luftës, bashkëpunimi i dobët vendor në trajtimin e rasteve, programet e papërshtatshme për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe ndryshimet e vazhdueshme të dëshmive të dëshmitarëve.<sup>23</sup>

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, UNMIK-u ndjeshëm uli praninë e tij dhe ndërpreu hetimin e krimeve të luftës si pjesë e një marrëveshjeje për dorëzimin e kompetencave relevante tek Bashkimin Evropian (BE).<sup>24</sup> Si rezultat, UNMIK-u i dorëzoi Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), informata në lidhje me një numër të përgjithshëm prej 1,187 veprash të dyshuara për krime lufte, plus 50 raste shtesë të cilat ishin të gatshme për aktakuzë.<sup>25</sup> I krijuar brenda kornizës së Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Bashkimit Evropian (PSDK), EULEX-i ishte i mandatuar në radhë të parë dhe më së shumti për të forcuar sundimin e ligjit në Kosovë, duke monitoruar, mentoruar dhe këshilluar institucionet gjyqësore të Kosovës, autoritetet policore dhe doganore, në një gamë të gjerë të çështjeve institucionale dhe operacionale. Ky mandat i gjerë ka pasur tendencë të vë në hije hetimet e krimeve të luftës; EULEX-i u dha përparësi rasteve të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, pasi që ato mendoheshin se ishin më të lehta për t'u hetuar dhe për t'u zgjidhur.<sup>26</sup>

Njësia e EULEX-it për Hetimin e Krimeve të Luftës ka ndihmuar në gjykimin e 38 rasteve të krimeve të luftës<sup>27</sup>, por, mesatarisht, secili rast mori pesë vjet për të përfunduar.<sup>28</sup> Në shumicën e rasteve, panelet e gjykatave hibride vendore, përbëheshin nga gjyqtarë vendorë dhe të BE-së, dhe mbështeteshin nga prokurorët dhe policia ndërkombëtare si dhe Prokuroria Speciale e Kosovës (PSK). Përkundër sfidave të shumta, EULEX-i ka ndihmuar në identifikimin e trupave të viktimave dhe vendeve ku personat e zhdukur janë varrosur dhe, kur rrethanat kanë lejuar, ka ndërmjetësuar në ndihmën e ndërsjellë juridike ndërmjet autoriteteve kosovare dhe serbe.<sup>29</sup> Megjithatë, hetimet e krimeve të luftës të EULEX-it u penguan ndjeshëm nga juridiksioni i kufizuar territorial dhe ligjor dhe mungesa e bashkëpunimit të Serbisë në rastet e krimeve të luftës në lidhje me autorët e dyshuar me banim në Serbi.<sup>30</sup>

Në vitin 2014, EULEX-i zvogëloi edhe më tej praninë e tij në Kosovë, gjë që rezultoi me reduktim të numrit të hetimeve të krimeve të luftës. Deri në vitin 2018, pritet që të gjitha rastet e krimeve të luftës të transferohen në gjyqësinë e Kosovës. Sidoqoftë, gjatë dhjetë viteve të fundit, kishte një tendencë në mesin e institucioneve gjyqësore vendase për të shmangur trajtimin e rasteve të krimeve të luftës dhe, sa herë që ishte e mundur, për t'i kaluar ato në EULEX. Ngurrimi i institucioneve gjyqësore vendase për të ndjekur penalisht rastet e krimeve të luftës është pjesërisht shkak i mungesës së mbrojtjes së duhur për prokurorët dhe gjykatësit, si dhe për shkak të frikës së hakmarrjes politike nga strukturat e kriminalizuara të pushtetit, të ngulitura në Kosovë.<sup>31</sup> Kjo tregon që institucionet kosovare nuk janë të gatshme të merren me rastet e krimeve të luftës që përfshijnë pjesëtarë të fuqishëm politikë të ish-UÇK-së dhe, në mënyrë të konsiderueshme, dëmton besueshmërinë e thirrjeve nga zyrtarët kosovarë për më shumë pronësi lokale të drejtësisë tranzicionale.<sup>32</sup> Në mbështetje të pronësisë lokale, EULEX-i ndihmoi autoritetet e Kosovës të ngrenë një departament të krimeve të luftës brenda

PSRK-së, e cila mbetet nën ombrellën e EULEX-it. Mungesa e gatishmërisë së Serbisë për të bashkëpunuar me organet kosovare për rastet që implikojnë serbët etnikë mbetet një faktor shtesë komplikues.

Institucionet e Kosovës dhe grupet e shoqërisë civile kanë ndërmarrë një gamë të gjerë të nismave të drejtësisë zhdëmtuese dhe restaruese për të krijuar një infrastrukturë institucionale dhe sociale për t'u marrë me të kaluarën.<sup>33</sup> Në vitin 2008, Qeveria e Kosovës themeloi një Komision Qeveritar për Personat e Zhdukur, së bashku me mbështetjen e mekanizmave të forenzikës, me qëllim të kërkimit të së vërtetës lidhur me personat e zhdukur. Një Grup Punues për Personat e Zhdukur, që përfshin Kosovën dhe Serbinë, ka ekzistuar që nga qeverisja aktive e UNMIK-ut në Kosovë. Qeveria e Kosovës jep dëmshpërblime në formën e pensioneve dhe privilegjeve të tjera për veteranët e luftës së UÇK-së, invalidët dhe familjet e "martirëve" (të vrarë të luftës së UÇK-së), për viktimat civile dhe të mbijetuarit e viktimat e dhunës seksuale gjatë konfliktit, të burgosurit politikë dhe civilët që pësuan lëndime fizike. Asistenca për këto kategori rregullohet nga ligje të veçanta dhe zbatohet nga struktura të veçanta institucionale. Përkundër këtyre skemave të kushtueshme të dëmshpërblimeve, viktimat civile dhe ato që i përkasin komuniteteve pakicë janë të pakënaqur për shkak të asaj që ata e shohin si qasje të kufizuar në dëmshpërblime.<sup>34</sup>

Një Grup Punues Ndërmintoror mbi Ballafaqimin me të Kaluarën dhe Pajtimin (GPNM) është themeluar në vitin 2012 dhe ka mandat për të hartuar një strategji kombëtare për drejtësinë tranzicionale në Kosovë.<sup>35</sup> Megjithatë, IMWG nuk arriti të promovojë të vërtetën dhe pajtimin etnik brenda Kosovës, kryesisht për shkak të mungesës së përkushtimit politik të Qeverisë së Kosovës, mosmarrëveshjeve të brendshme ndërmjet përfaqësuesve, mungesës së kapaciteteve dhe mbështetjes joadekuate të donatorëve.<sup>36</sup> Organizatat e shoqërisë civile në Kosovë dhe, më gjerë, në rajon kanë ndërmarrë një gamë të gjerë iniciativash për ballafaqimin me të kaluarën dhe për drejtësinë tranzicionale. Këto iniciativa kanë përfshirë përpjekjen për të krijuar një komision regjional të së vërtetës (RECOM) dhe përpjekjet kombëtare për të dokumentuar viktimat e konfliktit, për të monitoruar gjykimet e krimeve të luftës, për të mbështetur komunitetet e viktimave dhe për të identifikuar personat e pagjetur dhe të zhdukur.

Deri më tani, këto nisma të drejtësisë tranzicionale në Kosovë kanë prodhuar rezultate të përziera. Gjykatat ndërkombëtare dhe hibride të krimeve të luftës janë parë nga komunitetet shqiptare dhe serbe në Kosovë si mekanizma për të kërkuar llogari nga pala tjetër për keqbërjet, për të kultivuar një kulturë viktimizimi dhe për të zgjeruar fuqinë politike të linjave të ashpra nacionaliste. Gjykatat ndërkombëtare dhe hibride në Kosovë u përqëndruan kryesisht në drejtësinë penale dhe injoruan aspekte të tjera të drejtësisë tranzicionale, të tilla si kërkimi i së vërtetës, mbështetja e viktimave, kërkimfaljet, reparacionet dhe pajtimi i bashkësive.<sup>37</sup>

Orientuar drejt drejtësisë ndëshkuese, institucionet juridike hibride në Kosovë i janë nënshtruar mosmarrëveshjes dhe rezistencës dhe kanë qenë faktor të rëndësishëm në shfaqjen e dinamikës etno-nacionaliste të përkujtimit dhe dokumentimit monoetnik të krimeve të luftës, i përshatur kryesisht drejt konsolidimit të fuqisë brenda grupit dhe de-legitimimit të të tjerëve.<sup>38</sup> Derisa ka mbështetje të gjerë në të gjitha grupet etnike në Kosovë për idenë e trajtimit të krimeve të luftës, ekziston një dallim i madh midis shqiptarëve dhe serbëve kur bëhet fjalë për ndjekjen penale të individëve që u përkasin grupeve përkatëse etnike. Prandaj, pasoja e padëshiruar e drejtësisë penale ndërkombëtare në Kosovë dhe Serbi ka qenë glorifikimi i kryesve përkatës dhe marginalizimi i viktimave përkatëse.



Në të njëjtën kohë, procesi aktual i dialogut mes Kosovës dhe Serbisë po pengohet nga dështimi në ballafaqimin me të kaluarën dhe në zgjidhjen e çështjes së personave të pagjetur, dështimi për kërkimfalje për krime lufte dhe në pranimin se në të kaluarën është kryer dhunën në Kosovë. Kjo është e dukshme në rajonet më të prekura të Kosovës, ku komunitetet lokale vazhdimisht kundërshtojnë përpjekjet për pajtim dhe multietnicitetin e imponuar nga BE dhe aktorët kombëtarë.<sup>39</sup> Ndërsa këto dinamika të ngulitura janë të lidhura me mungesën e përkushtimit vendor për zgjidhjen e duhur të trashëgimive të jashtëzakonshme të së kaluarës, dialogu i lehtësuar nga BE për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë deri më tani nuk ka arritur të trajtojë çështjet lidhur me personat e pagjetur, krimet e luftës, drejtësinë për viktimat e krimeve të së kaluarës dhe dëmshpërblimet për humbjet njerëzore dhe ekonomike në Kosovë.

Shumë nga sfidat me të cilat Gjykata Speciale ka gjasa të përballet, janë nënproduktet e dështimeve të mëparshme për të ofruar drejtësinë e pritur për të gjitha viktimat dhe për të investuar seriozisht në zgjidhjen e çështjeve të jashtëzakonshme ndëretnike dhe ndërshtetërore që pengojnë paqen, pajtimin dhe zhvillimin në Kosovë, më gjerë, në rajon. Të dy palët, hisedarët ndërkombëtarë dhe kombëtarë, ndajnë përgjegjësinë për keqmenaxhimin e proceseve të drejtësisë tranzicionale në Kosovë. ♦

# 2. Kontekstualizimi i krijimit të Gjykatës Speciale të Kosovës

**G**jykata Speciale përfaqëson përpjekjen e fundit të bashkësisë ndërkombëtare për të trajtuar një sërë krimesh të dyshuara të luftës që mbeten problematike në Kosovë. Për të analizuar ndikimin e mundshëm eventual të saj, është e rëndësishme të kuptohet origjina e kontestuar e Gjykatës Speciale, karakteri i imponuar nga jashtë dhe veçoritë mono-etnike.

Gjykata Speciale është themeluar sipas ligjeve të Kosovës për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe krimet e tjera që u deklaruan në një raport të nxjerrë nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE) që u lirua më 7 janar 2011 (i njohur si Raporti Marty). Ky raport u bazua në punën e Komisionit Parlamentar të Këshillit të Evropës për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, i cili në vitin 2008 emëroi senatorin zviceran, Dik Marti, si raportues për të hetuar një numër pretendimesh dhe për të propozuar hapa të mëtejme.<sup>40</sup> Hetimi i PACE është ndikuar nga kujtimet e ish-prokurores së Tribunalit të Hagës, Karla Del Ponte, i cili ngriti pohime se krimet e kryera nga disa anëtarë të UÇK-së mbetën të pandëshkuara pasi që Tribunali i Hagës dhe UNMIK-u nuk qenë në gjendje të grumbullonin dëshmi të mjaftueshme.<sup>41</sup>

Raporti i Martit përvijon dy pohime të gjera për keqbërje kriminale, që nuk ishin adresuar.<sup>42</sup> Grupi i parë i akuzave kishte të bënte me zhdukjet, paraburgimet dhe vrasjet e pakicave etnike, kundërshtarët politikë shqiptarë etnikë dhe ata të lidhur me regjimin serb të Slllobodan Millosheviqit. Raporti i Martit sugjeronte që disa fraksione të UÇK-së mund të kenë kryer krime kundër të ndaluarve të kohës së luftës (para qershorit 1999) dhe të ndaluarve të pasluftës (pas qershorit 1999) për motive të ndryshme si hakmarrje, dënim dhe përfitim. Grupi i dytë i akuzave kishte të bënte me vrasjet e kryera për të mundësuar nxjerrjen dhe trafikimin e organeve njerëzore. Raporti i Martit akuzoi disa fraksione brenda UÇK-së (kryesisht nga rajoni i Drenicës) për drejtimin e një rrjeti të qendrave të ndalimit në Shqipërinë e veriut, për aktivitete të paligjshme. Publikimi i Raportit të Martit në vitin 2011 u prit negativisht nga shqiptarët etnikë në Kosovë, pasi ajo përputhej me fitoren e partive të afërta me UÇK-në në zgjedhjet kombëtare dhe lokale. Qeveria e Kosovës dhe publiku më i gjerë shqiptar kanë hedhur poshtë akuzat si përpjekje të mbështetura nga Serbia dhe Rusia për të implikuar UÇK në krime kundër njerëzimit

dhe krime të luftës, si përpjekje për të kundërbalancuar përgjegjësinë historike dhe ligjore të Serbisë për konfliktet e kaluara, për të minuar njohjen e pavarësisë së Kosovës, dhe për të dëmtuar përpjekjet për arritjen e pajtimit etnik nën mbikëqyrjen ndërkombëtare.<sup>43</sup>

Gjersa bashkësia ndërkombëtare i miratoi gjetjet, ata iu qasen Raportit Marty me kujdes sepse disa nga akuzat përfshinin OKB-në dhe Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), fillimisht për dështimin në hetimin e duhur të krimeve të dyshuara. Raporti i Martit dhe rezoluta e ndërlidhur e PACE-s, fillimisht nuk parashohin krijimin e një mekanizmi të veçantë gjyqësorë, siç janë Dhomat Speciale dhe Prokuroria Speciale. Në vend të kësaj, ky raport u kërkuan Shteteve Anëtare të BE-së dhe EULEX-it të ndajnë burimet dhe të konfirmojnë mbështetjen politike për hetimin e krimeve të dyshuara të luftës, duke u ofruar mbrojtje dëshmitarëve në Kosovë. BE kishte frikë se mosveprimi do të dëmtonte kredibilitetin e saj ndërkombëtar dhe strategjinë e saj të politikës së jashtme për promovimin e parandalimit të konflikteve dhe drejtësisë ndërkombëtare.<sup>44</sup> Opsioni i hetimit të krimeve të supozuara në Raportin e Martit përmes Tribunalit të Hagës ose strukturës ekzistuese të EULEX-it u konsiderua si jo i përshtatshëm për shkaqe politike dhe ligjore. Përveç çështjeve që kanë të bëjnë me juridiksionin dhe territorialitetin (mandati i Tribunalit të Hagës ishte të gjykonte krime në territorin e ish-Jugosllavisë gjatë periudhës së konfliktit të armatosur, ndërsa pretendimet në Raportin e Martit kanë të bëjnë me periudhën e pasluftës dhe përfshijnë krimet që pretendohet se janë kryer në Shqipërinë e veriut), Tribunali i Hagës ishte afër përfundimit të mandatit të saj dhe nuk ishte parashikuar një zgjatje e mëtejshme nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së. EULEX-it i mungonin burimet dhe mandati për të kryer një proces të tillë të ndërlidhur të drejtësisë penale.

Në vitin 2011, BE krijoi një Task Forcë Speciale Hetimore (TFSH) si zgjidhja më e mirë e mundshme për të kryer një hetim të pavarur në akuzat për krime të luftës dhe krimet të organizuar të bëra në Raportin Marty.<sup>45</sup> Komiteti Politik dhe i Sigurisë i BE-së, i cili mbikëqyrë misionet e përbashkëta të politikës së sigurisë dhe të mbrojtjes, të tilla si EULEX, autorizoi TFSH "të hetojë dhe, nëse është e justifikuar, të ndjekë penalisht individët për krimet e pretenduara" në Raportin e Martit dhe në mënyrë specifike "të ekzaminojë ndalimin e paligjshëm, deportimin, veprimet çnjerëzore, torturat dhe vrasjet, si dhe çdo krim tjetër i lidhur me pretendimet në raport".<sup>46</sup> Hetimi i TFSH u shtri edhe në territorin e Shqipërisë fqinje, pasi Raporti i Martit pretendonte se vendet në Shqipërinë veriore ishin përdorur për nxjerrjen dhe trafikimin e organeve. Për të mundësuar këto hetime, Shqipëria ishte e detyruar të miratonte një ligj të veçantë.<sup>47</sup> Zyrtarët e BE në Bruksel pranojnë se hetimet e TFSH u kryen derisa BE ishte duke përfunduar marrëveshjen e parë për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, duke ngritur pyetje në lidhje me rolin e hetimeve në lidhje me këto bisedime të ndjeshme.<sup>48</sup> Deri më tani, marrëveshja e parë e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila u nënshkrua në prill 2013, është zbatuar vetëm pjesërisht për shkak të mungesës së mbështetjes politike vendore dhe mosmarrëveshjeve në lidhje me modalitetet e zbatimit.<sup>49</sup> Megjithëse normalizimi i marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë dhe puna e Gjykatës Speciale janë procese të ndara, ato ka të ngjarë të ndikojnë në njëra-tjetrën gjatë viteve në vijim.

Pas dy vjet e gjysmë hetimi, prokurori kryesor i TFSH Clint Williamson lëshoi një deklaratë të gjatë me gjetjet paraprake nga ajo që ai e quajti "hetimi më gjithëpërfshirës që është bërë ndonjëherë për krimet e kryera në periudhën pas përfundimit të luftës në Kosovë në qershor 1999".<sup>50</sup> Rezultatet preliminare të TFSH ishin në përputhje me shumicën e pretendimeve të bëra në Raportin e Martit. Pa dhënë shumë detaje, TFSH pretendonte se kishte gjetur dëshmi për

të "ngritur aktakuzë kundër disa zyrtarëve të lartë të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", të cilët "mbajnë përgjegjësinë për një fushatë persekutimi që ishte e drejtuar kundër serbëve etnikë, romëve dhe popullsive tjera pakica në Kosovë dhe ndaj shqiptarëve të tjerë të Kosovës, të cilët ata i etiketonin ose të ishin bashkëpunëtorë me serbët ose, më së shpeshti, thjesht se kanë qenë kundërshtarë politikë të udhëheqjes së UÇK-së".<sup>51</sup> Deklarata e TFSH përmendi dëshmi se këto krime "janë kryer në mënyrë të organizuar dhe janë sanksionuar nga disa individë në nivelet më të larta të udhëheqjes së UÇK-së".<sup>52</sup> Prandaj, paditë ndaj disa zyrtarëve të lartë të ish UÇK-së kishin "të ngjarë të përfshinin akuza për krime lufte dhe shkelje të caktuara të ligjit vendor të Kosovës, duke përfshirë edhe vrasjen".<sup>53</sup> Lidhur me akuzat e diskutueshme të nxjerrjeve dhe trafikimit, TFSH arriti në përfundimin se "kjo praktikë kishte ndodhur në një shkallë shumë të kufizuar", por nuk kishte "asnjë indikacion se një pjesë e konsiderueshme e pakicave etnike që u zhdukën ose u vranë, ishin viktime të kësaj praktike".<sup>54</sup> E fundit por jo më pak e rëndësishme, TFSH arriti në përfundimin se mjedisi nuk ishte i favorshëm për ndërmarrjen e një hetimi të akuzave të Raportit Marti, në Kosovë. Duket se një nga arsyet kryesore për vendimin e BE-së për të zgjedhur një lokacion jashtë Kosovës për mekanizmin e hetimit dhe gjykimin të krimeve të supozuara, ishte reagimi negativ ndaj raportit të Martit në Kosovë, krahas kapacitetit të dobët gjyqësor për hetimin e krimeve të luftës dhe masave të pamjaftueshme për mbrojtjen e dëshmitarëve.<sup>55</sup>

Pas rekomandimeve nga TFSH, BE kishte pak alternativa, për të mos ofruar mbështetje politike dhe financiare për themelimin e Gjykatës Speciale.<sup>56</sup> Megjithatë BE e konsideron Gjykatën Speciale si një masë të pashmangshme në përforcimin e sundimit të ligjit në Kosovë, e parë nga perspektiva e drejtësisë tranzicionale, vetë BE e sheh drejtësinë penale si "një prioritet kyç për BE kur angazhohet në situata të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe ligjit ndërkombëtar penal".<sup>57</sup> Që nga fillimi, ishte e njohur se krijimi i një mekanizmi special gjyqësor për t'u marrë me pohimet e Raportit Marti dhe me gjetjet paraprake të TFSH do të kërkonte presion të gjerë diplomatik dhe politik mbi institucionet e Kosovës. Shtetet e Bashkuara dhe shumica e Shteteve Anëtare të BE i paralajmëruan haptazi institucionet e Kosovës që nëse nuk arrijnë të krijojnë një marrëveshje të veçantë për ta integruar brenda sistemit ligjor të Kosovës, shanset ishin të larta që Këshilli i Sigurimit i OKB do të autorizonte formimin e një gjykate speciale të OKB jashtë juridiksionit të Kosovës.<sup>58</sup> Për të shmangur krijimin e një gjykate të tillë të veçantë të OKB-së, institucionet e BE-së dhe Kosovës duhej të kalonin nëpër një proces të ndërlikuar ligjor dhe institucional, për të krijuar një marrëveshje për dhomat e internacionalizuara dhe të një prokurorie, që do të ishin zyrtarisht pjesë e sistemit ligjor të Kosovës, por me autonomi më të lartë gjyqësore dhe do të jenë të vendosura jashtë vendit. Pas presionit të fortë politik nga BE, u ra dakord që, së bashku me zgjatjen e mandatit të rikonfiguruar të EULEX-it, Presidentja e Kosovës do të mirëpriste edhe krijimin e një gjykate speciale.<sup>59</sup> Në një Shkëmbim Letrash me Përfaqësuesen e Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme, Catherine Ashton, Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga më 14 prill 2014 ra dakord se "një gjykatë speciale brenda sistemit gjyqësor të Kosovës dhe një prokurori speciale do të përdoren për çdo proces gjyqësor dhe apelues që rrjedhin nga hetimi i TFSH".<sup>60</sup> Shkëmbimi i Letrave u miratua më pas si ligj nga Kuvendi i Kosovës, më 23 prill 2014, gjë që shënoi përkushtimin e parë institucional të ndërmarrë nga autoritetet e Kosovës për të mbështetur themelimin e Dhomave Speciale dhe Prokurorisë Speciale.<sup>61</sup>

Themelimi i Gjykatës Speciale u bë rreth të njëjtës kohë, kur një panel i udhëhequr nga EULEX lëshoi vendimin për gjyqin e profilit të lartë të 15 ish anëtarëve të UÇK-së (të njohur si Grupi i Drenicës).<sup>62</sup> Gjyqi i Grupit të Drenicës u politizua shumë, duke shkaktuar protesta të zemëruara

dhe, sikur është pohuar, kërcënime të dëshmitarëve. Nën këto kushte të paqëndrueshme politike, projektligji për Gjykatën Speciale, i shkruar tërësisht nga Komisioni Evropian, u votua në një seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit.<sup>63</sup> Pas një beteje të gjatë politike midis BE-së dhe Qeverisë së Kosovës, u ra dakord që Gjykata Speciale të futet në sistemin ligjor të Kosovës, një marrëveshje e cila në mënyrë të pashmangshme kërkonte ndryshimin e Kushtetutës. Ndryshimet e nevojshme kushtetuese u miratuan përfundimisht më 7 mars 2015 pas një debati të ashpër politik në Kuvendin e Kosovës.<sup>64</sup> Në një situatë të paprecedentë, hezitimi i Kuvendit të Kosovës për të kaluar ndryshimet e nevojshme kushtetuese pothuajse shkaktoi një çarje në marrëdhëniet e Kosovës me Shtetet e Bashkuara.<sup>65</sup>

Amendamenti i ri i Kushtetutës (neni 162) parasheh që organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Gjykatës Speciale do të sqarohet me një ligj të veçantë. Ky ndryshim kushtetues thotë se Dhomat Speciale dhe Prokuroria Speciale "do të kenë personalitet të plotë juridik dhe juridik" dhe "të gjitha kompetencat dhe mandatet e nevojshme për funksionimin e tyre, bashkëpunimin gjyqësor, ndihmën, mbrojtjen e dëshmitarëve, sigurinë, paraburgimin dhe shërbimin e dënimit jashtë territorit të Kosovës për të gjithë të dënuarit".<sup>66</sup> Për të shmangur çdo pasiguri ligjore apo politike, Presidenti i Kosovës i dërgoi amendamentet kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës për një shqyrtim, i cili përfundimisht hapi rrugën për ndryshimin e legjislacionit të nevojshëm, që mundësoi zyrtarisht krijimin e Gjykatës Speciale të Kosovës.<sup>67</sup> Më 3 gusht 2015, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin nr. 05 / L-053 "Për Dhomat Speciale dhe Prokurorinë Speciale", i cili përcaktoi se, si një detyrim ndërkombëtar, këto institucione gjyqësore të vendosura jashtë vendit do të "sigurojnë procedime penale të pavarura, të paanshme, të drejtë dhe efikase në lidhje me akuzat për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë", të bëra në Raportin e Martit dhe nga TFSH.<sup>68</sup> Anëtarët e Kuvendit të Kosovës u kritikuan gjerësisht për mungesën e tyre të pavarësisë politike, votimin e bazuar në udhëzimet e partive të tyre dhe presionin e bashkësisë ndërkombëtare.<sup>69</sup>

Më 15 shkurt 2016, Qeveria e Kosovës dhe Mbretëria e Holandës nënshkruan një marrëveshje për të akomoduar Gjykatën Speciale në Hagë, me të vetmin qëllim për të siguruar funksionimin e saj të qetë dhe efikas në Holandë.<sup>70</sup> Marrëveshja jo vetëm që lejon Holandën të akomodojë Dhomen Speciale dhe Prokurorinë Speciale, por gjithashtu i jep të drejtën për të ndaluar të dyshuarit, si pjesë e procedurës penale. Për të siguruar funksionimin e saj efektiv, Gjykatës Speciale i janë dhënë privilegje, imunitete dhe lehtësi të plota diplomatike në Holandë, të tilla çfarë janë të nevojshme për përmbushjen e qëllimit të saj. Ajo do të veprojë sipas ligjeve dhe rregulloreve të shtetit pritës. Gjykata Speciale është e vendosur jashtë Kosovës kryesisht për shkak të frikës së bashkësisë ndërkombëtare që procedimet penale në Kosovë nuk do të prodhonin rezultate kuptimplota pasi autorët e supozuar janë thellësisht të rrënjosur brenda institucioneve dhe shoqërisë së Kosovës.<sup>71</sup> Ndërsa vendndodhja e Gjykatës Speciale jashtë Kosovës e zemëroi Qeverinë e Kosovës dhe disa grupe të caktuara të shoqërisë civile, kjo gjithashtu i lehtësoi institucionet vendore politike dhe gjyqësore për barrën e gjykimit të ish pjesëtarëve të UÇK-së për krimet e supozuara të përmendura në Raportin Marti.<sup>72</sup> Edhe pse strukturat e saj zyrtare gjyqësore janë të përfshira në sistemin kushtetues dhe ligjor të Kosovës, tiparet e veçanta të Gjykatës Speciale e bëjnë atë një gjykatë të ndërkombëtarizuar e cila është e ndarë nga Kosova në të gjitha aspektet, përveç emrit të saj dhe përkatësisë ligjore formale.<sup>73</sup> Struktura institucionale e Gjykatës Speciale ka huazuar elemente nga rregullat e procedurave dhe provave të Tribunalit të Hagës dhe nga gjykatat e ndryshme hibride të krimeve të luftës, duke përfshirë Gjykatën Speciale për Sierra Leone dhe Gjykatën Speciale për Libanin.

Dhomat speciale përbëhen nga dy organe kryesore: Dhomat dhe Regjistri. Dhomat përbëhen nga Kryetari i Dhomave dhe gjykatësit individualë të secilit nivel të sistemit gjyqësor në Kosovë, përkatësisht të Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese. Regjistri përbëhet nga Zyra e Mbrojtjes, Zyra për Pjesëmarrjen e Viktimave, Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve, Njësia për Menaxhimin e Paraburgimit. dhe Zyra e Ombudspersonit.<sup>74</sup> Njësia e Informacionit dhe Komunikimit Publik është gjithashtu pjesë e kësaj strukture.

Prokuroria Speciale është një organ i pavarur që ka "autoritetin për të kryer hetime penale dhe për të marrë përgjegjësinë për hetime penale të reja ose të mbetura pezull ose procedura brenda juridiksionit lëndor të Dhomave Speciale..."<sup>75</sup> Ajo do të mbështetet nga një strukturë e veçantë policore, e cila do të ushtrojë kompetencat që normalisht i jepen policisë së Kosovës sipas ligjit të Kosovës.<sup>76</sup> Derisa të gjitha autoritetet në Kosovë duhet të ndihmojnë Prokurorinë Speciale në hetimet e saj, ajo nuk do të merr udhëzime nga Qeveria e Kosovës dhe nuk do të ndajë ndonjë informacion me autoritetet e Kosovës.

Me seli në Hagë, Gjykata Speciale është e përbërë tërësisht nga gjyqtarë, prokurorë dhe zyrtarë administrativë jo-kosovarë, shumica europianë. Kjo është për shkak të natyrës së ndjeshme të procesit, shqetësimeve në lidhje me paanshmërinë dhe frikën se përfshirja e stafit lokal do të dëmtonte procesin hetimor. Përrjashtimi i shtetasve të Kosovës provokoi reagime të furishme në Kosovë dhe kontribuoi në një qëndrim më armiqësor ndaj Gjykatës Speciale.<sup>77</sup> Gjyqtarët emërohen nga Shefi i EULEX-it, sipas rekomandimit të një paneli të pavarur përzgjedhës që përbëhet nga gjyqtarë dhe të emëruar ndërkombëtarë me përvojë. Deri tani, janë emëruar 19 gjyqtarë dhe ata do të caktohen nga Kryetari i Dhomave. Përderisa Gjykata Speciale është pjesë përbërëse e sistemit gjyqësor të Kosovës, juridiksioni i saj përfshin personalitetin e plotë juridik dhe primat mbi të gjitha gjykatat e tjera në Kosovë.

Vlen të përmendet se Gjykata Speciale ka krijuar një aranzhim rigoroz dhe shumë të siguruar për mbrojtjen e dëshmitarëve, për të kapërcyer sfidat e hasura nga Tribunali i Hagës lidhur me frikësimin e dëshmitarëve dhe vdekjet. Gjykata Speciale ka ndërmarrë masa të avancuara për të garantuar sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e të gjitha viktimave dhe dëshmitarëve. Viktimave dhe dëshmitarëve u jipen gjithashtu privilegje dhe imunitete të plota nga proceset ligjore lidhur me dëshmitë e tyre me gojë ose me shkrim dhe nuk u nënshtrohen kufizimeve të emigracionit, kur ata udhëtojnë për të dhënë dëshmi ose për t'u paraqitur para gjykatave.

Ligji për Gjykatën Speciale përcakton se ajo do të gjykojë në pajtim me ligjin e Kosovës, si dhe ligjin zakonor ndërkombëtar mbi krimet e luftës dhe të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Gjykata Speciale do të ketë juridiksion të përkohshëm në lidhje me krimet që kanë ndodhur ndërmjet 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetor 2000 dhe juridiksionin territorial të kufizuar në lidhje me krimet që ose janë porositur ose janë kryer në Kosovë.<sup>78</sup> Juridiksioni i Gjykatës Speciale përfshin hetimin e krimeve të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare, të kryera gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë, të cilat dënohen me ligj kombëtar dhe ndërkombëtar. Derisa ligji ndërkombëtar mbulon krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, ligji i brendshëm i Kosovës mbulon krimet e zakonshme dhe sjelljet kriminale. Llojet e krimeve të luftës që Prokuroria Speciale do të hetojë, përfshijnë: "vrasje; shfarosje; skllavërim; deportim; burgim; torturë; përdhunim, skllavëri seksuale, prostitucion i detyruar, shtatëzani e detyruar dhe çdo formë tjetër e dhunës seksuale; përndjekje në baza politike, racore, etnike ose fetare; zhdukje me

forcë e personave; dhe veprime të tjera çnjerëzore.”<sup>79</sup> Ndërsa Gjykata Speciale do të kërkojë përgjegjësi penale individuale, asnjë person nuk do të gjykohet para këtij organi për akte që tashmë janë gjykuar nga Tribunali i Hagës ose nga një gjykatë e Kosovës.<sup>80</sup> Ligji për Gjykatën Speciale përcakton se "Rregullat e Procedurës dhe Provave duhet të përfshijnë dispozita që kanë të bëjnë me dëmshpërblimin e arsyeshëm ndaj Viktimave nga një i akuzuar i cili ka pranuar ose është shpallur fajtor për një krim, i cili ka rezultuar drejtpërdrejt në dëmtim të Viktimave.”<sup>81</sup>

Gjykata Speciale financohet nga BE-ja në kuadër të kornizës së politikës së përbashkët për siguri dhe mbrojtje, të dhënë nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë me Sekretarinë. Kontributet financiare ofrohen gjithashtu edhe nga vendet e treta. Siç përcaktohet në Ligjin për Gjykatën Speciale, ata "do të kenë buxhet, që nuk vie nga buxheti i Kosovës" dhe "nuk i nënshtrohet auditimit nga Auditori i Kosovës".<sup>82</sup> Kjo siguron që Gjykata e Specializuar ka autonomi të plotë financiare nga Qeveria e Kosovës. Gjykata Speciale u bë funksionale në qershor 2017, gati dy vjet pasi Kuvendi i Kosovës votoi në favor të themelimit të saj. Burimet e BE-së konfirmojnë se Gjykata Speciale ka ndërmarrë punë përgatitore për një paraqitje të qetë dhe efektive të akuzave. Megjithatë, ata nuk kanë dhënë asnjë informacion mbi strategjinë e prokurorisë.<sup>83</sup> Për shkak të vështirësive të dalura nga krijimi i Gjykatës Speciale dhe dështimit të proceseve të mëparshme të drejtësisë tranzicionale në Kosovë, është vendimtare të vlerësohen gjasat e Gjykatës Speciale për arritjen me sukses të qëllimeve të synuara dhe ndikimin e saj të mundshëm në paqen, stabilitetin dhe pajtimin në Kosovë dhe, më gjerë, në rajon. ♦

# 3. Vlerësimi i Ndikimit Potencial të Gjykatës Speciale të Kosovës

Në këtë fazë të hershme, mund të vërehet se Gjykata Speciale ka potencial të ketë një ndikim pozitiv shoqëror në Kosovë, ndërkohë që mund të shkaktojë rreziqe të caktuara. Kjo pjesë e këtij studimi hulumton ndikimin potencial pozitiv dhe shqyrton strategjitë e mundshme të zbutjes për rreziqet që rezultojnë nga puna e Gjykatës Speciale.

## 3.1 Identifikimi i ndikimeve potenciale pozitive

Pa dyshim, ndikimi kryesor i dëshiruar i Gjykatës Speciale është që të sjellë drejtësi tek viktimat dhe të mbajë përgjegjës personat e akuzuar për krimet e tyre. Një sondazh i kohëve të fundit i opinionit publik tregon se 47 përqind e shqiptarëve dhe 64 përqind e serbëve në Kosovë besojnë se një rezultat legjitim i punës së Gjykatës Speciale do të ishte dënimi i të gjithë të akuzuarve të cilët dëshmojnë fajtorë në përputhje me krimet që kanë kryer.<sup>84</sup> Përkrahje edhe më e madhe u konstatua në mesin e të dy grupeve etnike, kur është fjala për shërbimin e drejtësisë për viktimat dhe familjet e tyre. Përrjashtimi i autorëve të supozuar nga ndëshkimi rrezikon të përforcojë perceptimet shoqërore se këta individë janë të paprekshëm. Përtej dënimit të personave të shpallur fajtorë për krime,

### Ndikimet potenciale pozitive

1. Sjellja e drejtësisë për viktimat, llogaridhënia e personave të akuzuar për krimet e tyre dhe përfundimi i ciklit të mosndëshkimit;
2. Sigurimi i qartësisë ligjore dhe çlirimi i institucioneve dhe shoqërisë së Kosovës nga barra e akuzave;
3. Promovimi i llogaridhënies dhe sundimit të ligjit në Kosovë;
4. Hapja e hapësirës politike dhe shoqërore për aktorët vendorë për të diskutuar shkaqet, nxitësit dhe trashëgiminë e konfliktit në Kosovë;



Ligji për Gjykatën Speciale lejon mundësinë e urdhërimit të personave të dënuar për të kryer reparacione dhe dëmshpërblime ndaj viktimave. Kjo përfshin kompetencat që individët e dënuar të humbin pronën dhe asetet e përdorura ose të rrjedhura nga kryerja e veprës penale.<sup>85</sup>

Aktualisht, ekziston një mbizotërim në Kosovë i narracioneve viktimizuese brenda grupeve etnike. Disa nga të intervistuarit besojnë se duke pranuar vuajtjet dhe dëmet që u janë shkaktuar viktimave, Gjykata Speciale mund të ndihmojë në krijimin e simpatisë për vuajtjet e grupeve të tjera etnike gjatë dhe pas konfliktit si dhe të krijojë hapësirë për narrativa më pluraliste rreth viktimizimit në Kosovë.<sup>86</sup> Sjellja e drejtësisë për viktimat dhe familjet e atyre që janë prekur nga vrasjet etnike apo politike, zhdukja me forcë, dhuna seksuale, deportimi masiv dhe trajtimi çnjerëzor mund të kontribuojnë potencialisht në pajtimin etnik dhe në zgjidhjen e çështjeve të pazgjidhura në mes komuniteteve, si dhe atyre shoqërore e ndërshtetërore, si kthimi i pronave, kthimi i qëndrueshëm dhe riintegrimi, dhe bashkëjetesa paqësore në hapësirat dhe institucionet publike. Një sondazh i opinionit publik i bërë gjatë vitit 2015 konstatoi se "shumica e kosovarëve (59%) mendojnë, gjithashtu, se Gjykata Speciale ka të ngjarë të sjellë drejtësi për krimet e rënda të kryera në vitet 1990-ta".<sup>87</sup> Një sondazh më i fundit i opinionit publik i kryer në vitin 2017 tregon se 64.8 për qind e shqiptarëve etnikë dhe 53.2 për qind e serbëve etnikë thonë se është e rëndësishme të trajtohen të gjitha krimet e kryera ose krimet e vuajtura nga të gjithë civilët gjatë dhe pas luftës së viteve 1998 -99.<sup>88</sup> Megjithatë, ekspertët ligjorë, komentatorët politikë dhe aktivistët e shoqërisë civile në Kosovë, të vetëdijshëm për natyrën e zgjatur dhe komplekse të gjyqeve për krime lufte, nuk janë optimistë që Gjykata Speciale do të sjellë drejtësi të rëndësishme për viktimat dhe familjet e tyre në Kosovë.<sup>89</sup> Në veçanti, pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë shprehin ndjenja të përziera në lidhje me efektivitetin e Gjykatës Speciale, duke mbetur optimistë që ajo mund të kontribuojë në pajtimin etnik duke dërguar një mesazh se askush nuk është mbi ligjin në Kosovë dhe se nuk ka vend për mosndëshkim.<sup>90</sup>

Si një mekanizëm i ndërkombëtarizuar, Gjykata e Specializuar ka të ngjarë të sigurojë qartësi ligjore, duke hequr një 're' të pasigurisë që është hedhur mbi Kosovën nga akuzat e Raportit të Martit. Diskursi zyrtar i Qeverisë së Kosovës e kornizon themelimin e Gjykatës Speciale si një detyrim të pashmangshëm ndërkombëtar, i cili i ofron vendit mundësinë për të sqaruar akuzat lidhur me krimet e luftës, të bëra në Raportin e Dik Martit, dhe për të ndihmuar vendin të ecë përpara në arritjen e anëtarësimit të plotë në strukturat euroatlantike. Një sondazh i opinionit publik, që është bërë kohëve të fundit, tregon se 78 përqind e shqiptarëve në Kosovë e konsiderojnë presionin e aleatëve ndërkombëtarë të Kosovës si arsye kryesore për të cilën Kuvendi i Kosovës ka rënë dakord të themelojë Gjykatën Speciale.<sup>91</sup> Politikanët pragmatikë të Kosovës frikësoheshin se kundërshtimi i Gjykatës Speciale do të rrezikonte ekspozimin e vendit ndaj izolimit ndërkombëtar dhe do të pengonte përpjekjet për të zgjeruar njohjen e sovranitetit të Kosovës. Ata pohuan se Gjykata Speciale u krijua me kërkesë të aleatëve ndërkombëtarë të Kosovës dhe prandaj përfaqëson përkushtimin e Kosovës ndaj aleatëve të saj ndërkombëtarë, të cilët mbështetën çlirimin e Kosovës, kalimin e tij në shtetësi të pavarur dhe konsolidimin e vazhdueshëm të njohjes ndërkombëtare.<sup>92</sup> Përkundër pakënaqësive dhe mosmarrëveshjeve, pritet që në fund bashkëpunimi i Kosovës me drejtësinë ndërkombëtare do të rivendosë besimin e partnerëve ndërkombëtarë dhe ka gjasa të rrisë mbështetjen për përfundimin e njohjes diplomatike dhe sigurimin e anëtarësimit në organizatat kyçe ndërkombëtare dhe rajonale.

Mundësia që Gjykata Speciale të ketë një efekt pozitiv në promovimin e llogaridhënies dhe sundimit të ligjit në Kosovë nuk mund të përjashtohet. Gjykata Speciale paraqet një nga testet më sfiduese që duhet të kalojë shoqëria kosovare për të demonstruar se është një shoqëri e

hapur dhe demokratike, që respekton të vërtetën, drejtësinë dhe sundimin e ligjit. Ky do të jetë një tregues thelbësor i evropianizimit të shoqërisë kosovare dhe një deklaratë kolektive mbi drejtimin që Kosova dëshiron të marrë si shoqëri. Për disa, Gjykata Speciale përfaqëson një përpjekje të fundit nga BE dhe Shtetet e Bashkuara për të adresuar dështimet e mëparshme të Tribunalit të Hagës, UNMIK-ut, EULEX-it dhe autoriteteve gjyqësore të Kosovës për të hetuar siç duhet një pjesë të caktuar të krimeve të luftës që kanë të bëjnë me konfliktin e Kosovës.<sup>93</sup>

Ekziston konsensus ndërkombëtar që autoritetet vendore duhet të marrin timonin në hetimet e krimeve të luftës dhe t'i adresojnë ato nëpërmjet mekanizmave gjyqësorë vendorë.<sup>94</sup> Në veçanti, në Bruksel ekziston një perceptim i përgjithshëm se tani është koha që autoritetet e Kosovës të marrin përgjegjësinë për hetimet e tilla të krimeve të luftës.<sup>95</sup> Autoritetet e Kosovës hapur kanë diskutuar mundësinë e gjetjes së rrugëve të reja ligjore për paraqitjen e padive lokale, rajonale dhe ndërkombëtare për krimet e pandëshkuara të luftës dhe dëmet materiale të shkaktuara gjatë konfliktit në Kosovë.<sup>96</sup> Prandaj, Gjykata Speciale i jep Kosovës bazën morale dhe politike për të hapur një rrugë për institucionet gjyqësore për të marrë përgjegjësinë për hetimin e krimeve që lidhen me konfliktin, për të adresuar të gjitha krimet e pandëshkuara në Kosovë që prekin të gjitha grupet etnike, të jenë më të sigurt në ngritjen e çështjet e personave të zhdukur dhe dëmshpërblimet e luftës dhe të kërkojnë ndihmë nga BE në detyrimin e Serbisë për të bashkëpunuar më proaktivisht me autoritetet kosovare në sjelljen e drejtësisë për keqbërjet në të kaluarën dhe për krimet e rënda në Kosovë.

Një tjetër trashëgimi e mundshme pozitive e Gjykatës Speciale mund të jetë hapja e hapësirës politike dhe shoqërore për aktorët vendorë, për të diskutuar shkaqet, nxitësit dhe trashëgimitë e konfliktit në Kosovë. Herët a vonë, bashkësitë shqiptare dhe serbe duhet të kenë një diskutim të sinqertë rreth trashëgimisë së konfliktit, të vendosin drejt për viktimat dhe përgjegjësinë për shkeljet, të negociojnë kushtet e njohjes morale dhe të dëmshpërblimit material, dhe të ndërmarrin hapa konstruktiv për ndërtim të besimit dhe pajtimit. Në këtë kontekst, Gjykata Speciale ka potencialin për të kontribuar në një ndërgjegjësim më të gjerë për rëndësinë e kombinimit të proceseve të drejtësisë tranzitore ndëshkuese me ato zhdëmtuese, për t'u marrë në mënyrë gjithëpërfshirëse me trashëgimitë e hidhura të së kaluarës. Megjithëse nuk lidhet drejtpërsëdrejti me themelimin e Gjykatës Speciale, një mjedis më i favorshëm po shfaqet në Kosovë për të diskutuar një gamë të gjerë çështjesh tabu, të cilat janë injoruar për shumë vite, të tilla si njohja e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës dhe gatishmëria për t'u angazhuar dhe për të pranuar narrativa të shumëfishta të së kaluarës.<sup>97</sup>

Për më tepër, Gjykata Speciale ka potencialin për të transformuar gradualisht marrëdhëniet etnike në Kosovë duke thyer bllokada kolektive, siç janë pikëpamjet binare të autorëve dhe viktimave të konfliktit dhe shpërndarja kolektive e fajit për keqbërjet në të. Që nga përfundimi i konfliktit, komuniteti serb i Kosovës është vënë nën presion të madh nga forcat nacionaliste në Serbi ti mohon krimet e kryera nga regjimi i Millosheviçit dhe lidhjen e serbëve lokalë me ato keqbërje.<sup>98</sup> Në të njëjtën kohë, bashkësia serbe ka ardhur nën presionin e komunitetit shqiptar të Kosovës për

të pranuar fajësinë kolektive, për të kërkuar falje për krimet e luftës dhe për t'u integruar më shumë në shoqërinë kosovare. Në këtë kontekst, Gjykata Speciale mund të sigurojë kompensim simbolik për komunitetin serb në Kosovë, duke u mundësuar atyre që t'i tejkalojnë këto dilema binare përmes një kuptimi më të imtësuar të ndarjes së vuajtjeve në të dyja anët, gjë që mund të inkurajojë komunitetin serb që të angazhohet më pozitivisht me institucionet e Kosovës. Deri tani, një narrativ i viktimizimit kolektiv ka dominuar në mesin e shqiptarëve të Kosovës.

Rrjedhimisht, mundësia që krimet e luftës të kenë mundur të kryhen nga vetë kryengritësit e armatosur, mbetet një tabu publike. Gjykata Speciale mund të inkurajojë komunitetin shqiptar të Kosovës që të pranojë se disa anëtarë të grupit të tyre etnik, gjithashtu, kanë kryer krime lufte.<sup>99</sup>

Gjykata Speciale mund të ndihmojë në adresimin e çështjeve të pazgjidhura politike ndër-shqiptare. Pavarësia e Kosovës u arrit nga shqiptarët që favorizuan një rezistencë paqësore dhe jo të dhunshme, edhe nga ata që favorizuan një rezistencë të armatosur. Kjo rezultoi në polarizim brenda-etnik dhe konflikt politik, që vazhdojnë të ndikojnë në dinamikën politike dhe sociale në Kosovë.<sup>100</sup> Këta dy krahë të rezistencës shqiptare në Kosovë e kanë akuzuar njëri-tjetrin për raste të shumta të kryerjes së vrasjeve politike gjatë dhe menjëherë pas konfliktit.<sup>101</sup> Deri më sot, ka dhjetra raste të pazgjidhura të vrasjeve të motivuara politikisht të anëtarëve të lartë dhe gazetarëve të afërt me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Një zyrtar i lartë i LDK-së së voni argumentoi se "vrasjet politike nuk duhet të mbeten të pandëshkuara, veçanërisht ato që janë kryer në rrethana të rëndësishme dhe të ndjeshme për fatin e një vendi, siç ishte rasti me Kosovën, kur aktivistët e LDK-së u vranë - patriotët që dhanë gjithçka nga vetja për të arritur atë që kemi tani".<sup>102</sup> Derisa juridiksioni i përkohshëm i Gjykatës Speciale mund të mos mbulojë të gjitha vrasjet politike, të paktën Gjykata mund të hedhë dritë mbi disa nga këto akuza dhe të sjellë drejtësi për familjet e viktimave, si dhe të kontribuojë në pajtimin politik brenda-etnik.

Shumë në Kosovë duket se besojnë se Gjykata Speciale ofron një mundësi për të ndryshuar elitën e tanishëm politik në Kosovë, duke demonstruar kështu marrëdhëniet midis proceseve të drejtësisë tranzicionale dhe ndryshimit të regjimit. Nuk është sekret se një nga rolet kryesore të ndjekjes penale në kontekstin e drejtësisë tranzicionale është "të heqë disa prej kryesve më të këqij nga jeta publike dhe të dërgojë një sinjal të fortë për ata që mund të mendojnë për kryerjen e veprimeve të tilla në të ardhmen".<sup>103</sup> Disa komentatorë politikë në Kosovë argumentojnë se, ndërsa Gjykata Speciale u krijua për të ndëshkuar krimet e supozuara, ajo gjithashtu mund të ndihmojë në heqjen e ngulfatjes së tanishme politike në Kosovë.<sup>104</sup> Jo zyrtarisht, diplomatët e huaj nuk e mohojnë se ky proces i ndjeshëm mund të ofrojë zëra më të moderuar dhe më progresivë, si dhe një shtysë të re për të nxitur reformat dhe për t'i dhënë fund stanjacionit politik dhe ekonomik të vendit.<sup>105</sup>

Shumë nga elita politike aktuale në Kosovë dolën nga strukturat politike dhe ushtarake të UÇK-së. Ata kanë arritur fuqinë politike dhe legjitimitetin popullor kryesisht bazuar në të drejtën e tyre të vetëshpallur që rrjedh nga rezistenca e armatosur gjatë konfliktit. Roli i tyre i mëhershëm në luftën e armatosur, jo vetëm që u siguroi atyre mbështetje elektorale, por gjithashtu u dha mundësinë e okupimit dhe shfrytëzimit të institucioneve të reja shtetërore si një mburojë nga përgjegjësia për krimet e luftës së kaluar dhe për korrupsionin aktual e keqpërdorimin e pushtetit. Në këtë kuptim, megjithëse strukturat e fuqisë së kriminalizuar të pasluftës nuk janë objektiv i strategjisë prokuroriale të Gjykatës Speciale, kjo është një mundësi për të zbuluar rrugët e kontestuara drejt pushtetit politik në Kosovë. Megjithatë, përkundër këtyre pritjeve, ndryshimi politik përmes proceseve të jashtme të drejtësisë tranzicionale konsiderohet kundërproduktiv dhe mund të rezultojë në polarizimin e mëtejshëm politik në Kosovë.<sup>106</sup> Përkundër asaj që pritet shpesh, proceset e drejtësisë tranzicionale kanë bashkuar partitë politike të afërta me UÇK-në dhe kanë rritur popullaritetin dhe legjitimitetin politik, duke kundërshtuar kështu pasojat politike të akuzave të ngritura lidhur me sjelljen kriminale pas luftës.

## 3.2 Ruptimi i rreziqeve potenciale

Ndërsa Gjykata Speciale mund të jetë efektive në adresimin e krimeve të pandëshkuara të dokumentuara në Raportin e Martit, shumë njerëz janë skeptikë rreth ndikimit përfundimtar të këtij organi në Kosovë. Gjykata Speciale u krijua në një kohë kur përpjekjet për të funksionalizuar drejtësinë penale ndërkombëtare në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor nuk kishin qenë plotësisht të suksesshme në sjelljen e drejtësisë ndaj viktimave dhe në nxitjen e pajtimit. Qëndrimi i qytetarëve të Kosovës ndaj Gjykatës Speciale është kryesisht negativ për shkak të mandatit të tij të diskutueshëm dhe të ndjeshëm, mungesës së pronësisë lokale dhe transparencës rreth procesit dhe mungesës së besimit në drejtësinë tranzicionale në përgjithësi.<sup>107</sup>

### Rreziqet potenciale

1. Polarizimi i marrëdhënieve brenda-etnike dhe minimi i normalizimit të marrëdhënieve ndër-etnike në Kosovë;
2. Destabilizimin e mjedisit politik dhe të sigurisë dhe anashkalimin e reformave institucionale;
3. Njolllosja e reputacionit dhe pozitës ndërkombëtare të Kosovës;
4. Thellimi i mosbesimit lokal ndaj drejtësisë penale ndërkombëtare.

Brenda komunitetit etnik shqiptar, fokusi i ngushtë i juridiksionit të Gjykatës Speciale, i cili bazohet në shqyrtimin e pohimeve të Raportit të Martit, ka dobësuar legjitimitetin social dhe politik të këtij institucioni.<sup>108</sup> Një anketim i prillit 2017 tregon se 76.4 përqind e shqiptarëve etnikë besojnë se është e padrejtë që Gjykata Speciale kryesisht do të ndjekë penalisht krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit që lidhen me UÇK-në.<sup>109</sup> Skeptikët shqiptarë të Kosovës e perceptojnë Gjykatën Speciale si të imponuar padrejtësisht dhe të dëmshme për interesin dhe sovranitetin shtetëror të Kosovës. Mandati i ngushtë për të gjykuar vetëm krimet e supozuara të UÇK-së shihet si drejtësi selektive që nuk kontribuon në normalizimin e marrëdhënieve etnike në Kosovë. Për shumë njerëz, fakti se Gjykata nuk do të merret me të gjitha krimet e luftës në Kosovë dhe do të fokusohet vetëm në krimet e supozuara të shqiptarëve paraqet një politizim të thellë të drejtësisë penale ndërkombëtare. Në kontekstin ekzistues social dhe politik të Kosovës, ekziston një pakënaqësi e fortë midis shqiptarëve etnikë lidhur me dështimin e perceptuar të Tribunalit të Hagës për të ndëshkuar shumë krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të kryera nga regjimi serb, si dhe dështimin e bashkësisë ndërkombëtare për të sfiduar kulturën e mosndëshkimit dhe mohimit në Serbi. Për më tepër, presioni i paprecedent ndërkombëtar mbi institucionet e Kosovës për të themeluar Gjykatën Speciale konsiderohet jodemokratik dhe jolegjitim.<sup>110</sup> Opozita politike argumenton se Gjykata Speciale përfaqëson një përpjekje tjetër nga komuniteti ndërkombëtar për të hequr përgjegjësinë nga institucionet vendore në Kosovë pas dështimit të tyre për të administruar drejtësinë tranzicionale.<sup>111</sup>

Si një mekanizëm i imponuar nga jashtë, Gjykata Speciale tashmë përballet me një refuzim të fortë politik dhe shoqëror në Kosovë, i cili shoqërohet me kundërnarrativa të fuqishme dhe fushata mediatike që kritikojnë hetimet, procedurat dhe vendimet eventuale. Sondazhi i përmendur më parë tregon se rreth 50 përqind e shqiptarëve dhe serbëve etnikë besojnë se Gjykata Speciale nuk do të ofrojë gjykime të drejta, për shkak se vepron jashtë Kosovës dhe ka gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë.<sup>112</sup> Kjo ndjenjë e padrejtësisë mund të thellojë më

tejt mosbesimin vendor të drejtësisë ndërkombëtare, të kufizojë mundësitë për bashkëjetesë ndëretnike dhe përfundimisht të dëmtojë perspektivat për pajtim në Kosovë dhe, më gjerë, në rajon. Në veçanti, ekziston rreziku që Gjykata Speciale mund të antagonizojë viktimat shqiptare të Kosovës, të polarizojë marrëdhëniet etnike dhe, në skenarin më të keq, të nxisë dinamikën lokale dhe kombëtare të prishjes së paqes. Disa anëtarë të familjeve të viktimave dhe të mbijetuarve shqiptarë të Kosovës janë shprehur tashmë kundër Gjykatës Speciale dhe ata mund të humbasin besimin në gjykatat ndërkombëtare dhe të brendshme dhe aftësinë e këtyre gjykatave për të sjellë drejtësi për vuajtjet e tyre të e përjetuar në të kaluarën.<sup>113</sup> Familjet e personave të pagjetur dhe të viktimave civile dhe grupeve të afërta me UÇK-në mendojnë se ky proces nuk do të sigurojë drejtësi të balancuar ose nuk do të merret me shqetësimet e tyre.<sup>114</sup>

Komuniteti serb në Kosovë është i ndarë sa i përket ndikimit të mundshëm të Gjykatës Speciale. I ndikuar rëndë nga Beogradi, komuniteti serb në Kosovë nuk është i kënaqur me mekanizmat e drejtësisë tranzicionale që janë ngritur deri më sot, veçanërisht me gjykimet e krimeve të luftës, iniciativat në lidhje me dëmshpërblimet dhe njohjen për viktimat dhe të mbijetuarit.<sup>115</sup> Një sondazh i kohëve të fundit tregon se 69 për qind e serbëve të Kosovës besojnë se është e pamundur ose shumë pak e mundur, që Gjykata Speciale mund të sjellë drejtësi për ata që kanë kryer krime të rënda të luftës.<sup>116</sup> Ata kanë frikë se Gjykata Speciale do të ndjekë penalisht vetëm një pjesë të vogël të ish pjesëtarëve të UÇK-së, duke lënë mënjanë krimet e tjera të pandëshkuara, me qëllimin e vetëm të justifikimit të ndërhyrjes humanitare ndërkombëtare në Kosovë gjatë vitit 1999.<sup>117</sup> Përtej këtij skepticizmi, komuniteti serb që jeton në zonat jugore të Kosovës frikësohet se Gjykata Speciale mund të shkaktojë tensione etnike, duke dëmtuar sigurinë në zonat me popullsi serbe dhe lokacionet fetare në Kosovën jugore.<sup>118</sup>

Një pikëpamje e përbashkët midis grupeve të shoqërisë civile serbe është se Gjykata Speciale mund të shpërthejë narrativën dominuese se vetëm regjimi serb ka kryer krime lufte. Ata e shohin këtë si një parakusht thelbësor për fillimin e një procesi gradual të pajtimit. Derisa Serbia refuzon të kërkojë falje zyrtare për viktimat e krimeve të luftës të sponsorizuara nga shteti në Kosovë, disa grupe të shoqërisë civile serbe në Kosovë pranojnë se kanë ndodhur krime të luftës. Sondazhet e opinionit publik të para pesë viteve, zbulojnë se 40 përqind e serbëve të Kosovës pohojnë se serbët nuk kishin kryer krime në Kosovë, krahasuar me 80 përqind të shqiptarëve të Kosovës që besojnë se shqiptarët nuk kishin kryer krime të luftës.<sup>119</sup> Përkundër kësaj, shoqëria civile është në kurthin e narrativave mono-etnike në lidhje me të kaluarën dhe kuptimin e drejtësisë dhe pajtimit. Pavarësisht nga procesi i duhur ligjor dhe kostoja, duket sikur serbët në Kosovë do të kënaqen vetëm nëse figurat më të larta në institucionin politik të UÇK-së janë përgjegjës për krimet e luftës në Kosovë. Siç deklaroi një aktivist i shoqërisë civile serbe: "Ky është shansi i fundit për të bërë përpjekje për të balancuar gjërat".<sup>120</sup> Prandaj, Gjykata Speciale rrezikon të përforcojë një tendencë të rishikimit në Serbi dhe në mesin e komunitetit serb në Kosovë, që minimizon fushatën e spastrimit etnik të Serbisë dhe abuzimet në shkallë të gjerë të të drejtave të njeriut në Kosovë, duke u fokusuar vetëm në pasojat e pasluftës, të tilla si hakmarrjen etnike, zhvendosjen e njerëzve dhe plaçkitjen e pronës.

Shtetet e Bashkuara dhe Shtetet Anëtare të BE flasin me një zë të unifikuar mbi rëndësinë e sjelljes së drejtësisë për akuzat e ngritura në Raportin e Martit.<sup>121</sup> Megjithatë, ekziston një perceptim i gjerë i hisedarëve vendorë se proceset kalimtare në Kosovë po përdoren nga komuniteti ndërkombëtar për të sabotuar aktorët vendorë dhe për t'i detyruar ata të mbështesin politika dhe institucione të imponuara nga jashtë dhe për të miratuar ligje kundërtënëse.<sup>122</sup> Në veçanti, Gjykata Speciale shihet si një instrument i ri i sabotimit, i cili do të drejtojë reforma

të dhimbshme politike në Kosovë, duke përfshirë normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë dhe bashkëpunimin me misionet ndërkombëtare, që synojnë ruajtjen e stabilitetit vendor dhe rajonal.<sup>123</sup> Në këtë kontekst, puna e Gjykatës Speciale lehtë mund të keqprezentohet, si ndërrim i drejtësisë me stabilitetin politik dhe me kompromise të pafavorshme. Për më tepër, grupet kritike të shoqërisë civile frikësohen se Gjykata Speciale është duke u mirëpritur në Kosovë, jo që të sjellë drejtësi për krimet e luftës, por më shumë, që të mbrojnë një fraksion të elitës politike të Kosovës që është i implikuar në korrupsion dhe krim të organizuar.<sup>124</sup> Ky shihet si një proces që thëllon varësinë e Kosovës nga aktorët ndërkombëtarë për nxitjen e ndryshimeve shoqërore, që përfundimisht shfuqizon qytetarët dhe depolitizon demokracinë në vend.

Politizimi i punës së Gjykatës Speciale ka të ngjarë të ketë një ndikim negativ në dialogun Kosovë-Serbi, i cili aktualisht ka ngecur për shkak të dështimit të të dyja palëve për të zbatuar marrëveshjet ekzistuese. Që nga fillimi, partitë opozitare në Kosovë kanë kundërshtuar një dialog të pastrukturuar dhe të pakushtëzuar për normalizimin e marrëdhënieve pa njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Serbia, duke kërkuar ndjesë për krime lufte, duke i kthyer trupat e personave të pagjetur, duke ofruar dëmshpërblim për dëmet e luftës ose duke sjellur drejtësi për krimet e pandëshkuara. Gjykata Speciale rrezikon të kontribuojë më tej në jopopullaritetin e dialogut me Serbinë, nëse nuk është ristrukturuar në atë mënyrë që të adresojë njohjen e Kosovës dhe të inkorporojë drejtësinë tranzicionale në dialog. Për shumicën e shtetasve shqiptarë të Kosovës, ky është çelësi për normalizimin e marrëdhënieve midis dy shteteve dhe shoqërive.

Meqenëse Gjykata Speciale është ngritur për të hetuar dhe për të gjykuar krimet e supozuara të përshkuara në Raportin e Martit, kundërshtimet kryesore ka të ngjarë të ngrihen nga partitë politike të afërta me UÇK-në, shoqatat e veteranëve dhe individë të tjerë të prekur. Diplomatët e huaj jozyrtarisht pranojnë, se pasojat e punës së Gjykatës Speciale do të varen kryesisht nga ajo se cilët individë, brenda strukturave të ish UÇK-së, do të paditen dhe nga mënyra se si këta individë do të reagojnë pasi të jenë akuzuar.<sup>125</sup> Shumica e ish-strukturave të UÇK-së vazhdojnë të gëzojnë mbështetje të gjerë popullore në Kosovë. Paditë kundër udhëheqësve kryesorë të UÇK-së do të shkatërronin skenën politike të Kosovës, gjë që do të mund ta destabilizonte vendin. Nëse qeveria e ardhshme udhëhiqet nga partitë e afërta me UÇK-në, ajo mund të ndikohet rëndë nga aktakuzat, duke krijuar një seri të paparashikueshme të mosmarrëveshjeve politike brenda-shqiptare. Në anën tjetër, nëse qeveria tjetër përbëhet nga partitë jo-UÇK, partitë e afërta me UÇK-në do të kenë një nxitje të fortë për t'u rezistuar padive ndaj anëtarëve të tyre. Një sondazh i kohëve të fundit tregoi se 51 përqind e shqiptarëve etnikë do të ishin të gatshëm të protestonin nëse luftëtarët e UÇK-së do të paditeshin nga Gjykata Speciale, ndërsa 36 përqind do të ishin të përgatitur të vepronin për të parandaluar ndjekjen penale të pjesëtarëve të UÇK-së.<sup>126</sup>

Deri më tani, veteranët e UÇK-së kanë kërcënuar hapur se do të shkaktojnë probleme nëse lëshohen aktakuza për udhëheqjen politike dhe ushtarake të UÇK-së. Ndërsa këto kërcënime nuk janë të reja, ato nuk duhet të nënvlerësohen. Në të kaluarën, veteranët e UÇK-së kanë protestuar në mënyrë aktive kundër hetimeve dhe ndjekjes penale të ish luftëtarëve të UÇK-së, të ndërmarra nga Tribunali i Hagës, UNMIK-u dhe EULEX-i. Situata në përgjithësi ishte frenuar nga partitë pasardhëse të UÇK-së, të cilat bënë një zgjidhje strategjike për të kontrolluar veteranët përmes stimujve politikë dhe financiarë, duke 'blerë paqe' nga grupi më i ndjeshëm i interesave në vend.<sup>127</sup> Duke mos i mohuar këto rreziqe, disa nga të intervistuarit në Kosovë kanë deklaruar në mënyrë të përsëritur se mbështetja për strukturat e lidhura me UÇK-në ka rënë

gjatë viteve, sepse demografia e aktivizmit dhe ndarjet shoqërore dhe etnike kanë ndryshuar në favor të çështjeve tjera, më të afërta socio-ekonomike dhe ato të qeverisjes.<sup>128</sup> Shumë thonë se pavarësisht nga frika e shqetësimeve, përsëri Kosova është e përgatitur të merret me arrestimet dhe aktakuzat ndaj udhëheqësve politikë dhe ushtarakë të UÇK-së. Kosova ka përvojë në trajtimin e këtyre proceseve nga hetimet e zgjatura dhjetëvjeçare të Tribunalit të Hagës dhe EULEX-it për krimet e luftës në Kosovë.<sup>129</sup>

Megjithatë, ndikimi i gjerë shoqëror i Gjykatës Speciale do të varet shumë nga narrativat që elita politike dhe mediat do të përdorin në të ardhmen e afërt. Një sondazh i kohëve të fundit tregon se 38 përqind e shqiptarëve të Kosovës mendojnë se mund të mos marrin pjesë në protesta, nëse ish-komandantët e lartë të UÇK-së dhe udhëheqësit e bashkësisë ndërkombëtare flasin në favor të Gjykatës Speciale dhe deklarojnë se askush nuk është mbi ligjin.<sup>130</sup> Veçanërisht, Kosova ka një infrastrukturë të mirë mediatike për monitorimin dhe raportimin mbi drejtësinë, sundimin e ligjit dhe krimet e luftës, që mund të mobilizohet për të zbutur fushatat e njëanshme të aktorëve politikë.<sup>131</sup> Mjetet e reja të gazetarisë hulumtuese kanë dëshmuar të jenë mekanizma efektivë në komunikimin e procedimeve të gjykimeve të krimeve të luftës me publikun e gjerë në Kosovë. Shoqëria kosovare është pjekur dhe është bërë më tolerante dhe më e ndjeshme ndaj viktimave të krimeve të luftës, dhunës seksuale dhe tregimeve të vuajtjeve pa marrë parasysh përkatësinë etnike.<sup>132</sup> Sidoqoftë, shumica e mediave në Kosovë janë kryesisht monoetnike, politikisht të polarizuara dhe nganjëherë të prirura për të keqparaqitur fakte, ngjarje dhe personalitete, për të nxitur urrejtje dhe përdorur gjuhë denigruese dhe diskriminuese (megjithëse kjo është kundër kodit të shtypit të Kosovës dhe etikës së gazetari).<sup>133</sup> Në të kaluarën, mediat në Kosovë kanë qenë subjektive dhe të njëanshme në favor të anëtarëve të UÇK-së të cilët u paditën nga Tribunali i Hagës, UNMIK-u apo EULEX-i. Ngjashëm, raportimi i medias në Serbi lidhur me zhvillimet politike në Kosovë është i mbushur me gjuhën e urrejtjes, keqinformimit dhe nxitjen e ndarjes etnike.<sup>134</sup> Prandaj, ekzistojnë shumë parakushte që ky proces i drejtësisë tranzicionale të manipulohet nga mediat e jashtme dhe vendore për axhenda të ndryshme politike. Sfida tani është të zbuten këto ndikime negative.

Kohëve të fundit, në skenën ndërkombëtare ekziston një frikë se Gjykata Speciale ka gjasa të dëmtojë reputacionin e Kosovës dhe t'u japin kundërshtarëve të saj mundësinë për të minuar procesin e sigurimit të njohjeve diplomatike dhe anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare.<sup>135</sup> Ekziston rreziku që Serbia të përpiqet të kolektivizojë përgjegjësinë penale të shqyrtuar nga Gjykata Speciale, duke anuluar kështu fajin e vet për abuzimet kriminale të shkuara në Kosovë dhe në rajon. Megjithëse Serbia do të kishte preferuar një gjykatë speciale të administruar nga OKB, zyrtarët në Beograd haptazi kanë pohuar se "ne do të shfrytëzojmë çdo mundësi për të ndëshkuar kriminelët, pasi kjo është në interesin tonë".<sup>136</sup> Shanset janë të larta që Gjykata Speciale do të përdoret nga Serbia për të vonuar njohjen e Kosovës dhe për të inkriminuar themelet politike dhe etnike të luftës së Kosovës për pavarësi dhe shtetësi. ♦

# 4. Forcimi i Mundësive për Ndikim Pozitiv dhe Zbutje të Rreziqeve

**M**undësia e Gjykatës Speciale për të pasur një ndikim pozitiv në Kosovë, varet kryesisht nga përmirësimi i ndjekjeve penale vendore, duke shfrytëzuar bashkëpunimin e hisedarëve qeveritarë dhe duke përmbushur iniciativat e drejtësisë tranzicionale, veçanërisht ato që integrojnë gjetjen e së vërtetës, drejtësinë, zhdëmtimin dhe pajtimin.

## 4.1 Nevoja për një qasje pan-shoqërore drejt drejtësisë tranzicionale

Derisa drejtësia tranzicionale është pjesë përbërëse e përpjekjeve për ndërtimin e paqes pas konflikteve, në Kosovë, donatorët dhe prezenca ndërkombëtare diplomatike, organet qeveritare, partitë politike dhe - deri në njëfarë mase - grupet e shoqërisë civile nuk kanë bërë përpjekje gjithëpërfshirëse për t'u marrë me të kaluarën, për të ndërtuar paqen, dhe për të sjellur pajtimin.<sup>137</sup> Në këtë fazë të hershme, as aktorë kosovarë e as ndërkombëtarë, përfshirë këtu edhe Gjykatën Speciale, nuk duket se kanë një strategji të qartë se si të zbusin pasojat negative potenciale të punës së institucionit. BE-ja, Gjykata Speciale dhe diplomatët e huaj në Kosovë janë më të shqetësuar me aspektet procedurale dhe shpesh duket se po shmangin përgjegjësinë për pasojat e veprimeve të tyre.<sup>138</sup> Nëse pritjet e publikut nuk menaxhohen siç duhet, Gjykata Speciale ka gjasa të polarizojë më tej komunitetet etnike në Kosovë, që në skenarin më të keq mund t'i jap fund normalizimit të marrëdhënieve, të rris pasigurinë dhe të çojë në incidente të dhunshme ndëretnike.<sup>139</sup> Masat zbutëse të përshtatura, gjithëpërfshirëse dhe proaktive janë të nevojshme për t'u marrë me gamën e gjerë të efekteve të mundshme negative që Gjykata Speciale mund të prodhojë në Kosovë dhe, më gjerë, në rajon. Këto masa janë përgjegjësi jo vetëm të Gjykatës Speciale, por të të gjithë aktorëve kosovarë dhe



ndërkombëtarë. Për të zbutur efektet anësore të padëshiruara të Gjykatës Speciale, Qeveria e Kosovës dhe aktorët kryesorë ndërkombëtarë duhet të zhvillojnë një strategji gjithëpërfshirëse për drejtësinë tranzicionale dhe pajtimin në Kosovë.<sup>140</sup> Një qasje gjithëpërfshirëse e shoqërisë ndaj drejtësisë tranzicionale në Kosovë do të kërkonte mobilizimin e të gjithë sektorëve, duke përfshirë qeverinë, misionet ndërkombëtare dhe grupet e shoqërisë civile, për të forcuar perspektivat për një ndikim pozitiv dhe për të zbutur rreziqet që lidhen me Gjykatën Speciale.<sup>141</sup>

Një qasje e tillë gjithëpërfshirëse kërkon që Gjykata Speciale të hartojë dhe zbatojë një program gjithëpërfshirës dhe inkluziv, si dhe të punojë ngushtë me institucionet e Kosovës dhe grupet e shoqërisë civile. Institucionet e Kosovës duhet të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të bërë drejtësinë tranzicionale një politikë të qeverisë kombëtare, e cila do të kërkojë jo vetëm bashkëpunimin me mekanizmat ndërkombëtarë të drejtësisë, por gjithashtu zhvillimin e një infrastrukture më efektive institucionale dhe politike që mund të mbështesë iniciativat e tregimit të së vërtetës, duke rritur dialogun ndëretnik dhe duke mbrojtur komplementaritetin e iniciativave lokale, kombëtare dhe, më të gjera, rajonale për t'u ballafaquar me të kaluarën. BE-ja dhe shtetet anëtare të saj duhet të krijojnë hapësirë për drejtësi tranzicionale në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ato, gjithashtu, duhet të bëjnë përparim të mëtejshëm në proceset e anëtarësimit në BE, të kushtëzuara si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë me përpjekjet e kënaqshme për t'u ballafaquar me të kaluarën dhe për të bashkëpunuar me drejtësinë ndërkombëtare. Bashkësia më e gjerë ndërkombëtare në Kosovë duhet të dyfishojë përpjekjet për të garantuar se asistencat e ndërsjellë ligjore të funksionojnë mes Kosovës dhe Serbisë për hetimet e krimeve të luftës, personat e pagjetur, dëmshpërblimet dhe rikthimin e pronës.

Qe 18 vite pas konfliktit, çështja e personave të pagjetur mbetet e pazgjidhur. Përcaktimi i fatit dhe identifikimi i mbetjeve të personave të zhdukur gjatë konfliktit dhe pasojat e menjëhershme të saj është thelbësore për pajtimin në Kosovë. Deri në vitin 2017, ende ka mbi 1,600 persona të pagjetur, ndërsa rreth 3,400 trupa janë identifikuar. Çështja e fatit të personave të pagjetur është përdorur nga nacionalistët në Kosovë për të justifikuar mosgatishmërinë e tyre për të rivendosur marrëdhëniet me serbët në Kosovë. Një nga pengesat kryesore për identifikimin e trupave dhe personave të zhdukur është mungesa e vullnetit politik të Serbisë për të bashkëpunuar me komunitetin ndërkombëtar dhe autoritetet kosovare në gërmimin e vendeve të dyshuara për varre masive në Serbi. Sa i përket identifikimit të personave të pagjetur serbë në Kosovë, përpjekjet e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës janë gjithashtu të pamjaftueshme. Bashkësia ndërkombëtare dhe misionet e saj në Kosovë nuk kanë arritur t'i japin prioritet çështjes së personave të pagjetur. Identifikimi i trupave të personave të pagjetur dhe zgjidhja e fatit të të zhdukurve nga të gjitha grupet etnike, duhet të de-politizohet dhe të bëhet prioritet për të gjitha palët.

Hapi i parë drejt pajtimit është pranimi i së vërtetës. Ka mosmarrëveshje të fortë midis shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë në lidhje me atë se kur filloi dhe mbaroi "konflikti" dhe për periudhën që duhet të jetë fokusi i hetimit të krimeve.<sup>142</sup> Shumica e dhunës së sponsorizuar nga shteti serb kundër shqiptarëve ka ndodhur gjatë periudhës së konfliktit të armatosur (1998-99), ndërsa instancat me shkallë më të ultë të dhunës nga shqiptarët ishin më sporadike dhe vazhduan në periudhën pas konfliktit (deri më 2004). Nëse ka dy rrëfime kontradiktore për të kaluarën, atëherë mbetet perspektiva e përsëritjes së konfliktit. Prandaj, nëse shqiptarët dhe serbët në Kosovë mund të pajtohen për atë që ka ndodhur në të kaluarën, kjo do të ishte një hap i madh drejt një të ardhmeje më të mirë. Iniciativa e fundit e presidentit të Kosovës për

të ngritur një Komision për të Vërtetën dhe Pajtimin (KVP) për të "promovuar të vërtetën dhe pajtimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut", meriton angazhim kritik nga aktorët vendorë dhe ndërkombëtarë, veçanërisht nga komunitetet e viktimave dhe shoqëria civile.<sup>143</sup> Ndërsa ka pasur pjesëmarrje të gjerë në mesin e komuniteteve të viktimave, shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare në katër takimet konsultative përpara krijimit të KVP (Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin), mbetet të shihet nëse kjo iniciativë mund të bëhet një mekanizëm efektiv i kërkimit të së vërtetës dhe për të shmangur mangësitë e GPNM (Grupi Punues Ndër-Ministror për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtim), gati të pajetë.<sup>144</sup> Qeveria e Kosovës dhe shoqëria civile duhet të vendosin nëse do të ndjekin zhvillimin e vonuar të Strategjisë Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale në Kosovë. Në veçanti, marrëdhënia midis KVP dhe GPNM duhet të qartësohet më tej dhe të gjenden modalitete për të siguruar që KVP të plotësojë dhe të kontribuojë në iniciativat rajonale si RECOM (Komisioni regjional për vërtetimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljeve tjera serioze të të drejtave të njeriut).

Diskurset nacionaliste në Kosovë dhe Serbi kanë dëmtuar ndjeshëm legjitimitetin e proceseve të drejtësisë tranzicionale në rajon. Një ndryshim në diskursin nxitës dhe populist të elitës politike në Kosovë dhe Serbi është vonuar shumë; ata duhet të marrin një qëndrim më konstruktiv dhe pozitiv për paqen, zhvillimin dhe pajtimin. Komuniteti serb në Kosovë, veçanërisht politikanët lokalë dhe aktivistët e shoqërisë civile, duhet të shmangin përdorimin e Gjykatës Speciale për të krijuar ekuivalent të rremë midis krimeve të UÇK-së dhe krimeve të kryera nga Serbia në Kosovë. Të dy bashkësitë duhet të tregojnë pjekuri për të pranuar se krimet e shkallëve të ndryshme janë kryer nga të gjitha etnitë, në kohë të ndryshme dhe për arsye të ndryshme. Drejtësia tranzicionale duhet të sjellë sa më shumë autorë (të krimeve) që është e mundur në llogaridhënie, pa e shtrembëruar procesin duke u përpjekur të rialokojë fajin midis etnive ose të nxjerrë ekuivalenca. Që kjo të ndodhë, nevojitet një dialog i gjerë ndër-etnik për të arritur një kuptim gjithëpërfshirës të periudhës së konfliktit dhe pas tij dhe për të dalluar sjelljen kriminale të kohës së luftës dhe kohës së paqes, përkatësisht midis krimeve të kryera gjatë konfliktit dhe rutinës së përditshme ose dhunës së organizuar etnike. Për më tepër, disa nga ndikimet negative të Gjykatës Speciale mund të zbuten nëse Serbia ndryshon tonin dhe qëndrimin e saj ndaj këtij procesi të ndjeshëm dhe ndihmon në zgjidhjen e fatit të personave të pagjetur, bashkëpunon me autoritetet evropiane dhe kosovare për hetimet e krimeve të luftës dhe mbështet proceset e pajtimit lokal midis etnive brenda Kosovës.<sup>145</sup>

## 4.2 Mbyllja e boshllëkut të (keq)perceptimit

Mekanizmat ndërkombëtarë të drejtësisë penale shpesh minohen nga keqkuptimet në lidhje me kontekstin politik të krijimit të tyre.<sup>146</sup> Në Kosovë, dezinformimi publik dhe mungesa e njohurive rreth Gjykatës Speciale mbeten të përhapura. Një sondazh i kohëve të fundit tregon se 60.4 përqind e shqiptarëve etnikë dhe 59.2 përqind e serbëve etnikë nuk besojnë se kanë marrë informacion të mjaftueshëm për themelimin dhe rolin e Gjykatës Speciale.<sup>147</sup> Në mungesë të një fushate proaktive të informimit publik në Kosovë, shumë mite dhe narracione negative janë përhapur dhe kanë arritur të ndikojnë në perceptimet dhe qëndrimet e publikut në lidhje me Gjykatën Speciale.<sup>148</sup>

Një strategji e mirëpërgatitur e komunikimit dhe qasjes publike është thelbësore për të zbutur perceptimet negative dhe përhapjen e keqinformimit publik. Deri më tani, Njësia për Informim dhe Komunikim Publik në kuadër të Dhomës së Regjistrimit, ka mbajtur takime të mbyllura me

misionet dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë si dhe ka ndërmarrë takime konsultative me grupe të përzgjedhura të shoqërisë civile dhe media. Si e tillë, Dhoma e Regjistrimit duket se është duke ndjekur të njëjtin model të kontaktimit sikur edhe Tribunali i Hagës, i cili ishte kritikuar gjerësisht.<sup>149</sup> Gjykata Speciale ka humbur mundësinë për të mësuar nga gabimet e gjykatave të tjera ndërkombëtare të drejtësisë penale, veçanërisht në lidhje me rëndësinë e shtrirjes së hershme për të luftuar dezinformimin dhe perceptimet negative. Një faqe interneti, transmetimi i gjykimeve në TV dhe mbajtja e takimeve të mbyllura me hisedarët e përzgjedhur nuk janë të mjaftueshme për arritshmëri efektive. Njësia e Informimit dhe Komunikimit Publik duhet të jetë më e pranishme në Kosovë dhe të ketë arritshmëri deri tek grupet më të gjera të interesit. Pikëpamja e tanishme se institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për menaxhimin e pritjeve, duket e gabuar dhe duhet të ndryshojë.

Si çështje prioritare dhe urgjente, Gjykata Speciale duhet të hartojë një program më efektiv të shpërndarjes që përfshin aktorët kosovarë dhe ndërkombëtarë, për të siguruar që puna dhe trashëgimia e saj do të kuptohet dhe shpjegohet në mënyrë të duhur në Kosovë. Është e rëndësishme që Gjykata Speciale të ballafaqohet me mitet, thashethemet dhe kundër-narrativat për mandatin dhe procedurat e saj, duke ngritur bashkëpunimin me shumë organizata dhe individë në Kosovë. Nëse ajo nuk e bën këtë, rrezikon të ripërtërijë tensionet etnike në Kosovë pa u përballur me pasojat politike dhe fizike të një ndikimi kaq negativ. Krerët e tanishëm dhe të mëparshëm të misioneve diplomatike ndërkombëtare dhe bilaterale duhet të marrin një qëndrim më proaktiv në mbështetjen dhe komunikimin e punës së Gjykatës Speciale. Është vendimtare që ajo të ketë lidhje më të forta me organizatat e shoqërisë civile. Gjykata duhet gjithashtu të sigurojë qasje të mjaftueshme për monitorimin dhe raportimin e gjykimeve, pasi kjo mund të rrisë transparencën dhe disponueshmërinë e informatave të sakta publike.<sup>150</sup> Ndërsa gjyqtarët dhe prokurorët që punojnë në Gjykatën Speciale nuk japin llogari para institucioneve të Kosovës, është e rëndësishme që ata të kërkojnë llogaridhënien shoqërore përmes aktiviteteve të informimit publik dhe angazhimeve të tjera të dialogut, që sigurojnë që i gjithë procesi gëzon jo vetëm legjitimitetin procedural, por edhe legjitimitetin shoqëror në Kosovë.

### 4.3 Ngritja e bashkëpunimit të hisedarëve vendor

Deri më tani, institucionet e Kosovës kanë bashkëpunuar mirë me BE-në dhe hisedarë të tjerë ndërkombëtarë në themelimin dhe funksionalizimin e Gjykatës Speciale. Megjithatë, ekziston rreziku që institucionet vendore mund të rezistojnë në bashkëpunimin e duhur me organet e Gjykatës Speciale. Kjo mund të marrë formën e veprimeve të tërthorta të tilla si vonimi i formimit të një qeverie të re pas zgjedhjeve të qershorit, nxitja e krizave të tjera më urgjente, ose ndërmarrja e veprimeve për rishikimin e bazës ligjore të Gjykatës Speciale. Tani për tani, shumica e mekanizmave ligjorë për të zbatuar bashkëpunimin dhe pajtueshmërinë e institucioneve të Kosovës rregullohen me Ligjin për Gjykatën Speciale, që është pjesë integrale e së drejtës së brendshme të Kosovës. Përderisa një kornizë e fortë ligjore nuk është një garanci për zbatimin e suksesshëm në praktikë në rrethanat ku bashkëpunimi i institucioneve politike, gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit është thelbësor, Gjykata Speciale ka gjasa të përjetojë sfida praktike dhe ligjore që mund të komplikojnë dhe vonojnë gjykimet. Të gjitha misionet, UNMIK, Tribunali të Hagës dhe EULEX-it, janë përballur me rezistencë të rëndësishme institucionale nga autoritetet e Kosovës.

Aktualisht, bashkëpunimi i institucioneve të Kosovës varet në masë të madhe nga ajo se

kush vjen në pushtet pas zgjedhjeve të fundit. Partitë pasardhëse të UÇK-së formuan një koalicion parazgjedhor, i cili për shumë njerëz është simptomatik për dëshirën e tyre për t'u bashkuar përballë paqartësive që mund të sjellë Gjykata Speciale për pushtetin, strukturat dhe legjitimitetin e tyre popullor dhe ndërkombëtar.<sup>151</sup> Është shumë herët për të gjykuar se çfarë niveli të bashkëpunimit me Gjykatën Speciale mund të pritet nga një qeveri e re.

Në çfarëdo rasti, presioni mbi institucionet e Kosovës për të bashkëpunuar me Gjykatën e Speciale sipas të gjitha gjasave do të vijë nga jashtë.<sup>152</sup> BE-ja, para së gjithash, është e shqetësuar për të ruajtur dialogun Kosovë-Serbi dhe për të ruajtur stabilitetin rajonal. Duket se konsiderata kryesore e BE-së gjatë themelimit të Gjykatës Speciale nuk ishte aq shumë në drejtësinë tranzicionale, por që të ruhej investimi i BE në dialogun Kosovë dhe Serbi.<sup>153</sup> Derisa EULEX-i është i përfshirë në mandatin e Gjykatës Speciale, ai nuk duket i gatshëm që të angazhohet në zbutjen e pasojave negative nga puna e Gjykatës dhe nuk ka një strategji të qartë për ta bërë këtë. Si një kornizë detyruese, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) e BE-së detyron Kosovën "të bashkëpunojë plotësisht me TPNJ dhe mekanizmin e mbetur të tij, si dhe të gjitha hetimet dhe ndjekjet e tjera penale të kryera nën patronazhin ndërkombëtar".<sup>154</sup> Kjo e detyron Kosovën të bashkëpunojë jo vetëm me EULEX-in por edhe në mënyrë implicite me Gjykatën Speciale në dorëzimin e personave të paditur dhe ofrimin e asistencës së kërkuar politike dhe institucionale. Megjithatë, BE-ja dhe SHBA-të ka gjasa të përpiqen dhe të sigurojnë pajtimin me anën e nxitjeve politike dhe financiare në lidhje me integrimin evropian të Kosovës, ndihmën me reforma vendore dhe mbështetje për njohje ndërkombëtare dhe në anëtarësim.<sup>155</sup> Disa të intervistuar sugjerojnë se si mjet i fundit dhe si masë parandaluese, prania e EULEX-it dhe e paqerujtësve të NATO-s, mund të përdoret për të zbatuar urdhrat e Prokurorit Special dhe për të zbutur incidentet e dhunshme potenciale.<sup>156</sup>

Një nga strategjitë zbutëse më efektive, do të ishte përfshirja e temave që lidhen me personat e pagjetur, dëmshpërblimet për dëmet e luftës dhe bashkëpunimin e ndërsjellë ligjor në hetimin e krimeve të luftës në raundet e ardhshme të dialogut, të ndërmjetësuar nga BE-ja, në mes të Kosovës dhe Serbisë. Aktorët e shoqërisë civile në Kosovë në masë të madhe favorizojnë përfshirjen e drejtësisë tranzicionale në dialogun e lehtësuar nga BE për të përmirësuar masat për ndërtimin e besimit dhe për të rregulluar ndihmën e ndërsjellë juridike në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës.<sup>157</sup> Meqenëse formati i dialogut ekzistues lejon vetëm diskutimin dhe trajtimin e temave që janë reciprokisht të pranueshme, temat e personave të pagjetur dhe bashkëpunimi gjyqësor ndërkufitar mbi hetimet e krimeve të luftës mbeten të ndjeshme dhe hasin kundërshtim nga të dyja palët.<sup>158</sup> Serbia është e gatshme të mbajë fokusin e Gjykatës Speciale mbi krimet e pretenduara të kryera nga pjesëtarët e UÇK-së dhe nuk është e gatshme të angazhohet me aspekte të tjera të drejtësisë tranzicionale që do të rivendosin një fokus në keqbërjet serbe. Përkundër këtyre sfidave, Gjykata Speciale ofron një mundësi për të përfshirë drejtësinë tranzicionale si një temë të re në dialog dhe në të gjithë kornizën për pranim në BE, veçanërisht në raportet vjetore të vendit.

Ndonëse drejtësia tranzicionale mbetet në agjendën e zgjerimit të Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor, BE ka zvogëluar presionin ndaj qeverive kombëtare për të përparuar më tej në hetimet e krimeve të luftës, identifikimin e personave të pagjetur dhe pajtimin shoqëror. Kjo lidhet me shqetësimin në rritje të BE-së për rritjen e euroskepticizmit dhe ndjenjës anti-BE mes vendeve potenciale dhe kandidate të Ballkanit Perëndimor.<sup>159</sup> Sidoqoftë, BE ka një mundësi unike për të zbatuar kornizën e saj të re të politikave për drejtësinë tranzicionale në raport me Kosovën dhe Serbinë, e cila do të kontribuonte ndjeshëm në ndikimin shoqëror të dialogut të

lehtësuar nga BE dhe gjithashtu do t'i përgatisë këto vende për t'u bashkuar me BE.<sup>160</sup>

BE-ja si aktore rajonale ka një përgjegjësi politike dhe morale për të siguruar që Gjykata Speciale - një organ i mbështetur politikisht dhe financiarisht nga BE-ja - nuk prodhon pasoja negative që dëmtojnë stabilitetin politik dhe zhbëjnë përmirësimet në marrëdhëniet ndëretnike. Për këto arsye, BE-ja jo vetëm që duhet të shikojë Gjykatën Speciale nga perspektiva e sundimit të ligjit, por edhe ta plotësojë atë me përpjekje më të gjera për të promovuar pajtimin dhe për të normalizuar marrëdhëniet ndërmjet Kosovës, Serbisë dhe shteteve të tjera më gjerë, në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

#### 4.4 Rëgjallërimi i rolit të shoqërisë civile

Grupet e shoqërisë civile shpesh janë forca relativisht progresive në kontekstin e drejtësisë tranzicionale, të afta për të promovuar të vërtetën dhe për të lehtësuar dialogun shoqëror. Infrastruktura ekzistuese e shoqërisë civile në Kosovë përfaqëson shpresën më të madhe për të zbutur disa nga ndikimet e padëshiruara shoqërore të Gjykatës Speciale. Aktorët e shoqërisë civile në Kosovë që përfaqësojnë të dy bashkësitë etnike e njohin nevojën për një dialog shoqëror për pajtim që shkon përtej bisedimeve institucionale dhe formale të paqes. Po ashtu, ata e njohin rëndësinë e përfshirjes së drejtësisë tranzicionale në kurrikulat shkollore formale, pasi ekziston një mungesë e vërtetë e njohurive rreth të kaluarës komplekse të Kosovës, me konceptime të gabuara helmuese të krijuara nga rrëfimet monoetnike dhe tekstet nacionaliste të historisë shkollore. Organizatat e shoqërisë civile mund të jenë një partner i besueshëm në zbatimin e qasjes gjithëpërfshirëse të drejtësisë tranzicionale në Kosovë, duke rritur kështu përpjekjet nga poshtë-lart për drejtësinë restauruese dhe dialogun pajtues në Kosovë.

Megjithatë, puna e grupeve të shoqërisë civile në trajtimin e së kaluarës mbetet e ndjeshme. Aktivistët përballen me kritika të vazhdueshme nga forcat nacionaliste dhe shpesh i nënshtrohen fushatave publike të njollosjes. Në veçanti, shoqatat e viktimave mbeten të pambrojtura dhe të ekspozuara ndaj diskurseve nacionaliste dhe gjuhës së urrejtjes në sferën publike në Kosovë. Komuniteti i shoqërisë civile në Kosovë që punon në çështjet e drejtësisë tranzicionale vazhdon të mbështetet shumë në donacione të jashtme dhe ndërtimi i rrjeteve dhe bashkëpunimi është penguar nga konkurrenca për financim dhe mungesa e mbështetjes së mjaftueshme të donatorëve. Përfaqësuesit e shoqërisë civile në Grupin Punues Ndërmintor nuk kanë qenë në gjendje të kontribuojnë në mënyrë efektive në përfundimin e një Strategjie Kombëtare të Drejtësisë Tranzicionale në Kosovë, që është shumë e nevojshme.<sup>161</sup> Nevojitet një lëvizje më e fortë e shoqërisë civile në Kosovë, e cila projektton një vizion për drejtësinë tranzicionale strategjike me prioritete të qarta dhe që ka aftësi për të mobilizuar shoqërinë e për të ndikuar në axhendat e politikave në Kosovë dhe jashtë saj.

Ekziston gjithashtu nevoja për të shqyrtuar çështjen nëse duhet dhe si të krijohet hapësira për iniciativat ekzistuese kombëtare dhe më të gjera të drejtësisë tranzicionale rajonale siç janë RECOM, projektet e përbashkëta për përkujtim dhe dokumentim, si dhe format e drejtëpërdrejta dhe virtuale të përkujtimit në Kosovë, që mund të kontribuojnë në promovimin e së vërtetës, të ndryshojnë keqperceptimet etnike dhe gradualisht të rivendosin marrëdhëniet etnike dhe besimin e ndërsjellë.<sup>162</sup> BE-ja dhe donatorët e tjerë duhet të rrisin përkrahjen e tyre për punën e organizatave të shoqërisë civile në drejtësinë tranzicionale, për t'i lejuar ata të ndërmarrin aktivitete në terren me të rinjtë dhe komunitetet e viktimave. Për shembull, Zyra Rajonale për

Bashkëpunim të Rinisë, e themeluar kohët e fundit, mund të udhëheqë përpjekjet rajonale për dialogun shoqëror dhe pajtimin.<sup>163</sup> Potenciali i shoqërisë civile mund të përforcohet gjithashtu nga fondet e BE-së të dedikuara për të mbështetur projektet e drejtësisë tranzicionale kombëtare dhe ndërkufitare, për shembull, nëpërmjet Instrumentit kontribues në Stabilitetin dhe Paqen (IcSP) ose në Instrumentin e Ndhmës së Para-Anëtarësimit (IPA). ♦

# Konkluzionet dhe Rekomandimit

Gjykata Speciale e Kosovës përfaqëson përpjekjen më të fundit të bashkësisë ndërkombëtare për të adresuar akuzat e Raportit të Dik Martit. Megjithatë Gjykata Speciale është bërë funksionale dhe pritet të procedojë me aktakuza zyrtare gjatë vitit 2017, mungesa e mbështetjes politike dhe keqinformimi i përhapur në Kosovë mund të ndikojë në ndikimin e tij më të gjerë shoqëror. Si rezultat i kësaj, Gjykata Speciale ka gjasa të prodhojë efekte të përziera, disa prej të cilave mund të fuqizojnë të vërtetën, drejtësinë dhe pajtimin, dhe të tjerat të cilat mund të dëmtojnë stabilitetin politik dhe shoqëror në Kosovë. Për të përmirësuar ndikimin potencial pozitiv dhe për të zbutur rreziqet, hisedarët kryesorë kosovarë dhe ndërkombëtarë duhet të demonstrojnë përkushtim të qartë politik dhe të marrin veprime të përgjegjshme dhe të koordinuara në mbështetje të së vërtetës, drejtësisë dhe pajtimit në Kosovë. Si përfundim, ky studim ofron rekomandime politike specifike për një gamë të gjerë të aktorëve, që kanë për qëllim rritjen e mundësisë që Gjykata Speciale të ketë një ndikim pozitiv në Kosovë.

## GJYKATA SPECIOLE E KOSOVËS DUHET TË:

- ◆ Hartojë dhe implementojë një program të plotë dhe inkluziv të kontaktit dhe dialogut publik në Kosovë, i cili duhet të përshtatet për të shpjeguar qartë punën dhe mandatin e Gjykatës Speciale, duke trajtuar kështu keqinformimin dhe kundër-narrativën nacionaliste dhe duke punuar për të gjeneruar pranim të gjerë shoqëror të procesit dhe rezultatet e tij;
- ◆ Krijojë marrëdhënie pune efektive me institucionet e Kosovës dhe të zhvillojë takime të hapura konsultative dhe evente me hisedarët e interesuar vendorë, për të demonstruar pronësinë kosovare dhe për të siguruar përgjegjësi;
- ◆ Punojë ngushtë me grupet e shoqërisë civile në Kosovë dhe të krijojë një rol për ta në promovimin e kontaktit dhe dialogut publik, duke siguruar pjesëmarrje domethënëse të viktimave dhe duke monitoruar e raportuar mbi procedurat gjyqësore; dhe
- ◆ Sigurojë aktakuza, gjykime dhe vendime gjyqi në kohë dhe efektive, në përputhje të plotë me ligjet e Kosovës.

## INSTITUCIONET DHE AKTORËT POLITIKË TË KOSOVËS DUHET TË:

- ◆ Ofrojnë mbështetje të plotë politike, ligjore dhe teknike për Gjykatën Speciale duke siguruar që Ministria e Drejtësisë, Kuvendi dhe institucionet gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit të zbatojnë plotësisht të gjitha dispozitat e Ligjit mbi Gjykatën Speciale dhe të ofrojnë ndihmën e nevojshme në terren;
- ◆ Sigurojnë që të trajtohen të gjitha interesat e ngulitura dhe pengesat brenda institucioneve, të cilat mund të pengojnë punën e Gjykatës Speciale;
- ◆ Dyfishojnë përpjekjet për të fuqizuar drejtësinë dhe sundimin e ligjit, veçanërisht për të rritur kapacitetet e PSRK-së në hetimin e rasteve të krimeve të luftës dhe kapacitetet e gjyqësorit për të kryer gjyqe për krime lufte dhe për të zhvilluar mekanizma të reja institucionale për përmbushjen e këtyre qëllimeve;
- ◆ Përtërijnë përkushtimin dhe përkrahjen politike në nivelin më të lartë për të priorizuar zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale për Kosovën që ndërmerr një qasje të plotë në trajtimin e së kaluarës, qoftë nëpërmjet punës së një GPNM të përtërirë apo të ndojë organi tjetër;
- ◆ Hartojnë një infrastrukturë institucionale për koordinimin e iniciativave të drejtësisë tranzicionale vendore dhe kombëtare, duke përfshirë zbatimin efektiv të një Strategjie të ardhshme Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale;
- ◆ Të sigurojnë përfshirjen e gjerë dhe pronësinë e të gjitha komuniteteve relevante dhe të shoqërisë civile në procesin aktual të krijimit të një KVP, të sigurojnë mbështetje të mirëfilltë politike dhe financiare për këtë proces si dhe të sigurojnë pajtueshmërinë me proceset tjera të drejtësisë tranzicionale;
- ◆ Sigurojnë që Komisioni i Medias dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës të monitorojnë saktësinë dhe objektivitetin e raportimit të medias mbi punën e Gjykatës Speciale;
- ◆ Sigurojnë që agjencitë e zbatimit të ligjit në Kosovë të hartojnë plane, në bashkëpunim të ngushtë me EULEX-in dhe Forcën e Kosovës të udhëhequr nga NATO (KFOR), për të zbutur rreziqet ndaj sigurisë publike, që rrjedhin nga procedurat gjyqësore të Gjykatës Speciale;
- ◆ Përforcojnë rolin e Kuvendit të Kosovës në promovimin e proceseve të drejtësisë tranzicionale, duke u angazhuar për komunitetet e viktimave, duke luftuar interesat e rrënjësura politike, që bllokojnë pajtimin dhe duke kërkuar përgjegjësinë e qeverisë për t'u ballafaquar me të kaluarën; dhe
- ◆ Mbështesin pajtueshmërinë e iniciativave lokale, kombëtare dhe më të gjera rajonale për ballafaqimin me të kaluarën dhe drejtësisë tranzicionale dhe të luajnë një rol më aktiv në mbështetjen e përpjekjeve rajonale të pajtimit (RECOM).



## BE-JA DHE HISEDARËT KRYESORË NDËRKOMBËTARË NË KOSOVË DUHET TË:

- ◆ Përfshijnë çështjet e pazgjidhura, të lidhura me drejtësinë tranzicionale, në dialogun e lehtësuar nga BE për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë;
- ◆ Kushtëzojnë pranimin e Kosovës dhe Serbisë në BE në mënyrë më eksplicite dhe afirmative, me përparimin e kënaqshëm në ballafaqimin me të kaluarën dhe me mbështetjen e drejtësisë tranzicionale, duke ngërthyer këtu përfshirjen e drejtësisë tranzicionale në raportet vjetore të vendit;
- ◆ Ofrojnë më shumë mbështetje financiare për nxitjen e projekteve të drejtësisë tranzicionale vendore dhe ndërkufitare nëpërmjet IcSP dhe/ose IPA, si dhe prioritizimin e drejtësisë tranzicionale në projekte të tjera të shoqërisë civile, të financuara nga BE;
- ◆ Dyfishojnë përpjekjet për të garantuar funksionimin e asistencës së ndërsjellë juridike midis Kosovës dhe Serbisë në hetimin e krimeve të luftës;
- ◆ Njohin dhe shpërblejnë punën e institucioneve të Kosovës në mbështetje të Gjykatës Speciale, për shembull duke lehtësuar hyrjen pa viza në zonën Shengen, duke avancuar procesin e integritit evropian të Kosovës dhe duke mbështetur përpjekjet diplomatike të Kosovës për të siguruar njohje të reja dhe për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale; dhe
- ◆ Përmirësojnë koordinimin në mes donatorëve dhe aktorëve të tjerë ndërkombëtarë dhe të vënë si prioritet mbështetjen e iniciativave që merren me ballafaqimin me të kaluarën dhe drejtësinë tranzicionale në Kosovë.

## SHOQËRIA CIVILE DUHET TË:

- ◆ Zhvillojë një vizion strategjik për drejtësinë tranzicionale në Kosovë, që ngërthen në vete fuqizimin e kapaciteteve organizative dhe zhvillimin e fushatave të qarta të komunikimit strategjik si dhe projekteve afatgjata;
- ◆ Krijojë një koalicion ose rrjet të ri të shoqërisë civile për drejtësinë tranzicionale në Kosovë, që rregullon avokatinë proaktive në emër të viktimave, duke adresuar tek Qeveria e Kosovës dhe hisedarët ndërkombëtarë, me investime serioze në ngritjen e kapaciteteve dhe fushata publike efektive dhe të qëndrueshme, që luftojnë narrativat nacionaliste dhe përjashtuese;
- ◆ Punojë ngushtë me Njësinë për Informim dhe Komunikim Publik (në kuadër të Dhomës së Regjistrimit), për të krijuar një strategji proaktive, shumë-aspektëshe dhe transparente të komunikimit dhe shpërndarjes për të zbutur efektet e padëshiruara potenciale;
- ◆ Merr një rol proaktiv në udhëheqjen dhe plotësimin e iniciativave kombëtare dhe, më të gjera, rajonale, për ballafaqimin me të kaluarën, duke përfshirë edhe procesin e themelimit të një KVP-je dhe RECOM-i. ◆

# Fusnotat

- 1 'Gjykatat hibride' janë mekanizma të posaçëm të drejtësisë penale vendore, që përbëhen nga një kombinim i gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit ekzekutiv ndërkombëtar e vendor dhe që gjykojnë krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe krimet të tjera të rënda, bazuar në të drejtën ndërkombëtare dhe vendore.
- 2 Derisa Dhomat Speciale dhe Prokuroritë Speciale të Kosovës janë institucione diskrete, ky raport aplikon terminologjinë në përdorimin e zakonshëm në Kosovë, duke iu referuar "Gjykatës Speciale" si një entitet.
- 3 Shihni Impunity Watch, 'Praktika e Drejtësisë Tranzicionale: Shikim prapa, ecje përpara', maj 2016. Mund të gjendet në: [http://www.impunitywatch.org/docs/scoping\\_study\\_FINAL.pdf](http://www.impunitywatch.org/docs/scoping_study_FINAL.pdf) (qasja më 16 May 2017). Shih, po ashtu, Janine N. Clark, Gjykimet Ndërkombëtare dhe Pajtimi: *Vlerësimi i Ndikimit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë*. Abingdon: Routledge, 2014.
- 4 Kirsten Ainley, Rebekka Friedman dhe Chris Mahony, 'Drejësia Tranzicionale në Sierra Leone: Teoria, Historia dhe Vlerësimi', në: Kirsten Ainley, Rebekka Friedman dhe Chris Mahony (eds) *Vlerësimi i Drejtësisë Tranzicionale: Llogaridhënia dhe Ndërtimi i Paqes pas konfliktit në Sierra Leone*. Basingstoke: Palgrave Macmillan, 2015, f. 6.
- 5 Për më shumë detaje, shihni: Hugo Van Der Merwe, Victoria Baxter dhe Audrey R. Chapman (eds), *Vlerësimi i Ndikimit të Drejtësisë Tranzicionale: Sfidat për Hululumtë Empirik*, Washington, DC: USIP Press, 2009; Oskar N.T. Thomas, James Ron dhe Roland Paris, 'Efektet e nivelit shtetëror të Drejtësisë Tranzicionale: Çfarë dimë ne?' *Zhurnali Ndërkombëtar i Drejtësisë Tranzicionale*, Vëll. 4, Nr. 3, 2010, f. 329-354.
- 6 Për një diskutim më të gjerë të rëndësisë së kontekstit në drejtësinë tranzicionale, shih Roger Duthie dhe Paul Seils (eds), *Mozaikët e Drejtësisë: Si formëson konteksti Drejtësinë Tranzicionale në shoqëritë e përqara*, New York: Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale, 2017.
- 7 Qendra e të Drejtës Humanitare, 'Libri i Kujtimeve të Kosovës', Prishtinë, 2011. Mund të gjendet në: <http://www.kosovomemorybook.org> (data e qasjes: 24 May 2017).
- 8 Komsioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën, *Raporti i Kosovës: Konflikti, Reagimi Ndërkombëtar dhe Mësimet e Nxjerrura*, Oxford: Oxford University Press, 2000.
- 9 Shih UNDP, 'Perceptimet mbi Drejtësinë Tranzicionale', Prishtinë, 2012. Mund të gjendet në: [http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/TJ/English-Web\\_965257.pdf](http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/TJ/English-Web_965257.pdf) (data e qasjes: 20 May 2017).
- 10 Shih Gëzim Visoka, 'E vërteta e arrestuar: Drejtësia Tranzicionale dhe Politika e Përkujtimit në Kosovë', *Zhurnali i Praktikës së të Drejtave të Njeriut*, Vëll. 8, Nr. 1, 2016, f. 62-80.
- 11 Drejtësia tranzicionale inkorporon një grup të mekanizmave, praktikave dhe çështjeve që kërkojnë të ballafaqohen dhe të merren me shkeljet në të kaluarën të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare në mënyrë që të sigurojnë llogaridhënien dhe të arrijnë pajtimin. Shih Këshilli i Sigurimit të KB, 'Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Sundimin e Ligjit dhe Drejtësinë Tranzicionale në Shoqëritë në Konflikt dhe Pas Konfliktit', UN Doc. S/2004/616, 23 gusht 2014. Shih po ashtu: Olivera Simić (ed) *Hyrje në Drejtësinë Tranzicionale*, Abingdon: Routledge, 2017.
- 12 Për analiza më të gjera legale, shih Sarah Williams, 'Dhomat Speciale të Kosovës: Limitet e Internacionalizimit?', *Journal of International Criminal Justice*, Vëll. 14, Nr. 1, 2016, f. 25-51.
- 13 Impunity Watch, 'Konferencë Politike: Fuqizimi i Impaktit Shoqëror të Gjykatave Penale Ndërkombëtare', Utrecht, shkurt 2015. Mund të gjendet në: [http://www.impunitywatch.org/docs/Policy\\_Brief\\_-\\_Enhancing\\_the\\_Societal\\_Impact\\_of\\_International\\_Criminal\\_Tribunals.pdf](http://www.impunitywatch.org/docs/Policy_Brief_-_Enhancing_the_Societal_Impact_of_International_Criminal_Tribunals.pdf) (data e qasjes: 19 June 2017).
- 14 Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara dhe Asembleja e Përgjithshme, 'Raporti i Gjykatës Ndërkombëtare për Ish-jugosllavinë', Dok. i KB A/71/263-S/2016/670. 1 gusht 2016.
- 15 GJPNIJ, Deklaratë nga Carla Del Ponte, 'Prokurorja e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për Ish-Jugosllavinë mbi Hetimin dhe Ndjekjen Penale të Krimeve të Kryera në Kosovë', Hagë, 29 shtator 1999.
- 16 Një përjashtim nga kjo, ishin Haradin Bala and Lah Brahimaj, të cilët u shpallën fajtorë dhe u dënuan me burgim për 13 vjet dhe 6 vjet respektivisht.
- 17 Për më shumë detaje, shih të dhënat në GJPNIJ për rastin Haradinaj dhe të tjerët: <http://www.icty.org/case/haradinaj/4>.
- 18 GJPNIJ, 'Raport i Presidentit mbi Konferencën, Vlerësimi i Trashëgimisë së GJPNIJ', Hagë, 27 prill 2010. Mund të gjendet në: [http://www.icty.org/x/file/Press/Events/100427\\_legacyconference\\_pdt\\_report.pdf](http://www.icty.org/x/file/Press/Events/100427_legacyconference_pdt_report.pdf) (data e qasjes: 28 prill 2017).
- 19 Për diskutim akademik dhe kritik, shih Janine N. Clark, Gjykimet Ndërkombëtare dhe Pajtimi: *Vlerësimi i Ndikimit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për Ish-Jugosllavinë*. Abingdon: Routledge, 2014.
- 20 Për diskutim relevant, shih Aaron Fichtelberg, *Gjykatat Hibride: Shqyrtim Krahasues*, New York: Springer, 2015.

- 21 Amnesty International, 'Kosova: Koha që EULEX-i t'u jap prioritet krimeve të luftës'. Raporti nr. EUR 70/004/2012. London, 2012. Mund të gjendet në: [http://www.amnesty.eu/content/assets/260412\\_EULEX\\_Report.pdf](http://www.amnesty.eu/content/assets/260412_EULEX_Report.pdf) (Data e qasjes: 20 maj 2017).
- 22 OSBE, 'Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kosovë: Një vlerësim dhjetë vjet më pas (1999–2009)', Prishtinë, maj 2010, p. 6. Mund të gjendet në: <http://www.osce.org/kosovo/68569?download=true> (Ata e qasjes: 23 prill 2017).
- 23 Qendra e së Drejtës Humanitare në Kosovë, 'Dëshmitarët, ende Thembra e Akilit në Gjykimet e Profilit të Lartë', Prishtinë, 1 prill 2014. Mund të gjendet në: <http://www.hlc-rdc.org/?p=26515&lang=de> (Data e qasjes: 13 prill 2017).
- 24 Shih Gëzim Visoka dhe Grace Bolton, 'Natyra komplekse dhe implikimet e angazhimit ndërkombëtar pas pavarësisë së Kosovës', *Luftërat Civile*, Vëll.13, Nr.2, 2011, f. 189-214.
- 25 Këshilli i Sigurimit të KB, 'Raporti i Sekretarit Gjeneral mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë', Dok. i KB S/2009/149, 17 mars 2009, para. 19.
- 26 Intervistë personale me një zyrtar të lartë të EULEX-it për të drejtat e njeriut, Prishtinë, 28 prill 2017.
- 27 EULEX, 'Drejtesi për Krimet e Luftës - Nevojitet Bashkëpunim i Fuqizuar Gjyqësor', Prishtinë, 28 mars 2017. Mund të gjendet në: <http://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,27,605> (Data e qasjes: 2 maj 2017).
- 28 Ibid.
- 29 Amnesty International, 'Varrosja e së kaluarës: 10 vite mosndëshkim për zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë në Kosovë', Raporti Nr. EUR 70/007/2009, Londër, 2009. Mund të gjendet në: <http://www.amnesty.org/en/documents/eur70/007/2009/en/> (accessed 25 April 2017).
- 30 EULEX, 'EULEX dhe Krimet e Luftës', pa datë. Mund të gjendet në: <http://www.eulex-kosovo.eu/en/news/000427.php> (Data e qasjes: 4 maj 2017).
- 31 Intervistë personale me një ekspert të drejtësisë tranzicionale, Prishtinë, 2 maj 2017.
- 32 Komisioni Evropian, 'Komunikata e vitit 2016 për Politikën e Zgjerimit të BE-së', 9 nëntor 2016, f. 30. Mund të gjendet në: [https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_kosovo.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf) (data e qasjes: 3 maj 2017). Shihni, po ashtu: Qendra për të Drejtën Humanitare në Kosovë, 'Me kalimin e kohës, zbehet drejtësia për krime lufte', Prishtinë, 2016. Mund të gjendet në: <http://hlc-kosovo.org/?wpdm=5098> (Data e qasjes: 20 prill 2017).
- 33 Për një pasqyrë të përgjithshme, shih UNDP Kosovë, 'Ballafaqimi me të kaluarën dhe pajtimi në Kosovë: Një përmbledhje e institucioneve dhe iniciativave', Prishtinë, 2017.
- 34 Shih Qendra për të Drejtën Humanitare në Kosovë, 'Viktimit civile: Çfarë qasje për bashkësitë?' Prishtinë, 30 nëntor 2016. Mund të gjendet në: <http://hlc-kosovo.org/?wpdm=4975> (data e qasjes: 20 maj 2017).
- 35 Qeveria e Kosovës, 'Vendimi Nr. 03/77 i datës 4 qershor 2012, mbi Themelimin e Grupit Punues Ndër-Ministror për Ballafaqimin me të Kaluarën dhe për Pajtim' (WG DwPR).
- 36 Shih Nora Ahmetaj dhe Thomas Unger, 'Korniza e Kosovës për ballafaqimin me të kaluarën në një pikë kthese: Shqyrtimi i shoqërisë civile për progresin drejt një Strategjie Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale', prill 2017. Mund të gjendet në: [http://www.impunitywatch.org/docs/Civil\\_society\\_review\\_report\\_final\\_ENG\\_8.51.pdf](http://www.impunitywatch.org/docs/Civil_society_review_report_final_ENG_8.51.pdf) (data e qasjes: 20 mars 2017).
- 37 Anna Di Lellio dhe Caitlin McCurn, 'Inxhinjeria e Bazave të Drejtësisë Tranzicionale në Ballkan: Rasti i Kosovës', *Politika dhe Shoqëritë e Evropës Lindore*, Vëll. 27, Nr. 1, 2013, ff. 129-48.
- 38 Shih Gëzim Visoka, 'E vërteta e arrestuar: Drejtësia Tranzicionale dhe Politika e Përkujtimit në Kosovë', *Zhumali i Praktikës së të Drejtave të Njeriut*. Vëll. 8, Nr. 1, 2016, f. 62-80.
- 39 Intervistë personale me një aktivist të shoqërisë civile në Kosovë, Prishtinë, 27 prill 2017.
- 40 Shih, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Komisioni për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, Trajtimi çnjerëzor i njerëzve dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë, Dok. 11574 (15 prill 2008)
- 41 Shih, Carla Del Ponte dhe Chuck Sudetic, Zonja Prokurore: *Konfrontimi me kriminelët më të këqinj të njerëzimit dhe kultura e mosndëshkimit*, New York: Other Press, 2009.
- 42 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, 'Trajtimi çnjerëzor i njerëzve dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë', Dok. Nr. 12462, 7 janar 2011. Mund të gjendet në: <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/X2H-Xref-ViewPDF.asp?FileID=12608&lang=en> (Data e qasjes: 2 prill 2017).
- 43 Intervistë personale me një këshilltar të qeverisë së Kosovës, Prishtinë, 25 prill 2017.
- 44 Për më shumë detaje, shih Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm (EEAS), 'Korniza Politike e BE-së mbi Mbështetjen e Drejtësisë Tranzicionale', Bruksel, nëntor 2015. Mund të gjendet në: [http://eeas.europa.eu/archives/docs/top\\_stories/pdf/the\\_eus\\_policy\\_framework\\_on\\_support\\_to\\_transitional\\_justice.pdf](http://eeas.europa.eu/archives/docs/top_stories/pdf/the_eus_policy_framework_on_support_to_transitional_justice.pdf) (data e qasjes: 4 Maj 2017).
- 45 Intervistë personale me një zyrtar të EEAS, Bruksel, 16 maj 2017.
- 46 FFSH 'Factsheet', Bruksel, korrik 2014, f.1. Mund të gjendet në: [http://sif.eu/images/fact\\_sheets/sif\\_factsheet\\_en.pdf](http://sif.eu/images/fact_sheets/sif_factsheet_en.pdf) (data e qasjes: 25 prill 2017).

- 47 TFSH, 'TFSH mirëpret ligjin e Shqipërisë mbi bashkëpunimin', Bruksel, 10 maj 2012. Mund të gjendet në: <https://sif.eu/index.php/en/news-other/21-sif-welcomes-news> (data e qasjes: 21 maj 2017).
- 48 Intervistë personale me një zyrtar të EEAS, Bruksel, 16 maj 2017.
- 49 Shih Gëzim Visoka dhe John Doyle, 'Paqja Neo-Funksionale: Mënyra e Bashkimit Evropian për Zgjidhjen e Konfliktëve', *Zhurnal i Studimit të Tregjeve të Përbashkëta*, Vëll. 54, Nr. 4, ff. 862-877.
- 50 Ibid., p. 1.
- 51 TFSH, 'Deklarata e Kryeprokurorit të Task Forcës Speciale Hetimore', Bruksel, 29 korrik 2014, f. 1, Mund të gjendet në: [http://www.balkaninsight.com/en/file/show/Statement\\_of\\_the\\_Chief\\_Prosecutor\\_of\\_the\\_SITF\\_EN.pdf](http://www.balkaninsight.com/en/file/show/Statement_of_the_Chief_Prosecutor_of_the_SITF_EN.pdf) (data e qasjes: 28 maj 2017).
- 52 Ibid., f. 2.
- 53 Ibid., f. 2.
- 54 Ibid., f. 3.
- 55 Intervistë personale me një zyrtar të EEAS, Bruksel, 16 maj 2017.
- 56 Intervistë personale me një zyrtar të Komisionit Evropian, Bruksel, 15 maj 2017.
- 57 Këshilli i Bashkimit Evropian, 'Konkluzionet e Këshillit mbi Mbështetjen e BE-së për Drejtësinë Tranzicionale', Bruksel, 16 nëntor 2015, f. 2. Mund të gjendet në: <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-13576-2015-INIT/en/pdf> (data e qasjes: 28 maj 2017).
- 58 Intervistë personale me një diplomat të huaj në Prishtinë, më 26 prill 2017.
- 59 Intervistë personale me një ish-këshilltar në Qeverinë e Kosovës, Prishtinë, 28 prill 2017.
- 60 Kuvendi i Kosovës, "Për ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Misionin Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë 2014 (Ligji Nr. 04 / L-274) dhe Shtojca e Shkëmbimit të Letrave", Prishtinë, 23 Prill 2014, f. 3. Mund të gjendet në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-274%20a.pdf> (data e qasjes: 27 prill 2017).
- 61 Ibid.
- 62 Shih: Marija Ristic, 'Gjyqi i trazuar i "Grupit Drenica" të Kosovës, Drejtësia Tranzicionale e Ballkanit, Prishtinë 25 maj 2015. Mund të gjendet në: <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-awaits-kl-guerilla-verdict> (data e qasjes: 22 qershor 2017).
- 63 Shih: Besiana Xharra, 'Gjykata Speciale, pa gjyqtarë shqiptarë', Zeri, Prishtinë, 19 shkurt 2015. Mund të gjendet në: <http://zeri.info/aktuale/20439/gjykata-speciale-pa-gjyqtare-shqiptare/> (data e qasjes: 22 qershor 2017).
- 64 Kuvendi i Kosovës, 'Transkripti i Sesionit të Jashtëzakonshëm të Kuvendit të Kosovës', Prishtinë, 3 gusht 2015.
- 65 Gazeta Express, 'Jacobson: Nëse Kosova dështon, Gjykata Speciale do të krijohet nga OKB', 3 qershor 2015. Mund të gjendet në: <http://www.gazetaexpress.com/en/news/jacobson-should-kosovo-fail-special-court-will-be-created-by-the-un-105330/> (data e qasjes: 15 prill 2017).
- 66 Kuvendi i Kosovës, 'Amendamenti i Kushtetutës së Republikës së Kosovës', dok. Nr. 05-D-139, 3 gusht 2015. Mund të gjendet në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Amendment%20of%20the%20Constitution%20no%202024.pdf> (data e qasjes: 18 prill 2017).
- 67 Gjykata Kushtetuese e Kosovës, "Vlerësimi i një Amendamenti në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe i referuar nga Presidenti i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 9 mars 2015 me Letër Nr. 05-433jDO-318", nr. i rastit. KO26/15, Prishtinë, 15 prill 2017, f. 13. Mund të gjendet në: [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/KO26-15\\_ANG.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/KO26-15_ANG.pdf) (data e qasjes: 19 prill 2017).
- 68 Kuvendi i Kosovës, 'Ligji nr. 05 / L-053 për Dhomat Speciale dhe Prokurorinë Speciale', Neni.1
- 69 Shih IndeksOnline, 'Gjykata Speciale në shënjestër të kritikëve', Prishtinë, 11 gusht 2016. Mund të gjendet në: <http://indeksonline.net/lajmet/gjykata-speciale-ne-shenjestere-te-kritikeve-8467/> (data e qasjes: 22 qershor 2017).
- 70 Shih 'Marrëveshja ndërmjet Mbretërisë së Holandës dhe Republikës së Kosovës lidhur me akomodimin e institucionit gjyqësor special të Kosovës të zhvendosur në Holandë', 15 shkurt 2016.
- 71 Intervistë personale me një diplomat të BE, Bruksel, 16 maj 2017.
- 72 Intervistë personale me një këshilltar të qeverisë së Kosovës, Prishtinë, 25 prill 2017.
- 73 Shih Sarah Williams, 'Dhomat Speciale të Kosovës: Limitet e Internacionalizimit?', *Zhurnal i Drejtësisë Ndërkombëtare Kriminale*, Vëll. 14, Nr. 1, 2016, ff. 25-51.
- 74 Kuvendi i Kosovës, 'Ligji nr. 05 / L-053 për Dhomat Speciale dhe Prokurorinë Speciale', Prishtinë, 3 gusht 2015, Neni 24.
- 75 Ibid., Neni 35.
- 76 Shih Ligji SCSPo, neni 35.9 (faqe 30) <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-053%20a.pdf>.
- 77 Koha Net, 'Specialja pas asnjë kosovar', Prishtinë 8 maj 2017. Mund të gjendet në: <http://www.koha.net/arberi/17110/specialja-pa-asnje-kosovar/> (data e qasjes: 22 qershor 2017).
- 78 Ibid., Nenet 7 dhe 8.
- 79 Kuvendi i Kosovës, 'Ligji Nr. 05 / L-053 mbi Dhomat Speciale dhe Prokurorinë Specialise', neni 13.1.

- 80 Ibid., Neni 17.
- 81 Ibid., Neni 22.
- 82 Ibid., Neni 63.
- 83 Intervistë personale me një diplomat të BE-së, Bruksel, 16 maj 2017.
- 84 Të dhëna të pabotuara nga PAX, CPT, Impunity Watch dhe Integra, 'Perceptimi publik i Gjykatës Speciale të Kosovës', Prishtinë, prill 2017.
- 85 Kuvendi i Kosovës, 'Ligji nr. 05 / L-053 mbi Dhomat Speciale dhe Prokurorinë Speciale', Neni 44.
- 86 Intervista personale me aktivistë të shoqërisë civile në Kosovë, prill-maj 2017.
- 87 UNDP, 'Raporti i Pulsit Publik Nr. 10, Prishtinë, tetor 2015, f. 14. Mund të gjendet në: [http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic\\_governance/public-pulse-10.html](http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-10.html) (data e qasjes: 18 maj 2017).
- 88 Të dhëna të pabotuara nga PAX, CPT, Impunity Watch dhe Integra, 'Perceptimi publik i Gjykatës Speciale të Kosovës', Prishtinë, prill 2017, f. 1.
- 89 Intervistë personale me një ekspert të drejtësisë tranzicionale në Kosovë, Prishtinë, 25 prill 2017.
- 90 Intervistë personale me një aktivist të shoqërisë civile serbe të Kosovës, Prishtinë, 28 prill 2017.
- 91 Të dhëna të pabotuara nga PAX, CPT, Impunity Watch dhe Integra, 'Perceptimi publik i Gjykatës Speciale të Kosovës', Prishtinë, prill 2017.
- 92 Intervistë personale me një këshilltar të lartë politik në Qeverinë e Kosovës, Prishtinë, 27 prill 2017.
- 93 Intervistë personale me një aktivist të shoqërisë civile shqiptare të Kosovës, Prishtinë, 2 maj 2017.
- 94 Intervistë personale me një zyrtar të EEAS, Bruksel, 16 maj 2017.
- 95 Ibid.
- 96 Intervistë personale me një këshilltar të lartë politik në Qeverinë e Kosovës, Prishtinë, 27 prill 2017.
- 97 Intervistë personale me një ish-politikan në Kosovë, Prishtinë, 3 maj 2017.
- 98 Shih: Janine N. Clark, Gjykimet Ndërkombëtare dhe Pajtimi: Vlerësimi i Ndikimit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë. Abingdon: Routledge, 2014; Jelena Obradovic, Konflikti etnik dhe krimet e luftës në Ballkan: tregimet e mohimit në Serbinë pas konfliktit. London: I.B. Tauris, 2013. Eric Gordy, Faji, Përgjegjësia dhe Mohimi: E Kaluara në rrezik në Serbinë Post-Milloseviçiane. Philadelphia, PA: University of Pennsylvania Press, 2013.
- 99 Për krahasim, shih: UNDP, 'Perceptimi Publik mbi Drejtësinë Tranzicionale', Prishtinë, maj 2007. Mund të gjendet në: <http://www.uboconsulting.com/publications/Transitional%20Justice.pdf> (Data e qasjes: 23 maj 2017); UNDP, 'Perceptimet mbi Drejtësinë Tranzicionale', Prishtinë, 2012. Mund të gjendet në: [http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/TJ/English-Web\\_965257.pdf](http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/TJ/English-Web_965257.pdf) (Data e qasjes: 20 maj 2017).
- 100 Shih: Crisis Group, 'Çfarë ndodhi me UÇK-në?', Balkans Report Nr. 88, Prishtinë, 3 mars 2000. Mund të gjendet në: <https://www.crisisgroup.org/europe-central-asia/balkans/kosovo/what-happened-kl> (Data e qasjes: 22 qershor 2017); Crisis Group, 'Dhuna në Kosovë: Kush po e vret kënd?', Balkans Report Nr. 78, Prishtinë, 2 nëntor 1999. Mund të gjendet në: <https://www.crisisgroup.org/europe-central-asia/balkans/kosovo/whos-killing-whom-kosovo> (Data e qasjes: 22 qershor 2017).
- 101 Shih: ABA CEELI, 'Vrasjet Politike në Kosovë/Kosovo, mars-qershor 1999', Washington, D.C., shtator 2000. Mund të gjendet në: <https://www.hrdag.org/wp-content/uploads/2015/07/kosovo-politicalkillings-2000-cc.pdf> (Data e qasjes: 20 maj 2017); Jock Covey, Michael Dziedzic dhe Leonard Hawley (eds), *Kërkimi për Paqe të Qëndrueshme: Ndërrhyrja Ndërkombëtare dhe Strategjitë për Transformimin e Konfliktëve*, Washington, DC: USIP Press, 2005.
- 102 Gazeta Zëri, 'Gecaj: Nuk do të lejojmë të harrohen vrasjet politike', 17 prill 2017. Mund të gjendet në: <http://zeri.info/aktuale/139280/gecay-nuk-do-te-lejojme-te-harrohen-vrasjet-politike/> (Data e qasjes: 28 prill 2017).
- 103 David Backer, 'Analizë Krahasuese Ndër-Kombëtare', në Hugo Van Der Merwe, Victoria Baxter dhe Audrey R. Chapman (eds), *Vlerësimi i Ndikimit të Drejtësisë Tranzicionale: Sfidat për Hulumtime Empirike*, Washington, DC: USIP Press, 2009, f. 34.
- 104 Shih Koha Net, 'Tribunali i Ri e çiron edhe e shpëton Kosovën', 4 prill 2014. Mund të gjendet në: <http://archive.koha.net/?id=31&o=67> (Data e qasjes: 8 April 2017).
- 105 Intervistë personale me një diplomat të huaj në Prishtinë, 26 prill 2017.
- 106 Intervistë personale me një aktivist të shoqërisë civile shqiptare të Kosovës, Prishtinë, 4 maj 2017.
- 107 Intervistë personale me një aktivist të shoqërisë civile shqiptare të Kosovës, Prishtinë, 25 prill 2017.
- 108 Intervistë personale me një këshilltar ligjor të qeverisë së Kosovës, Prishtinë, 24 prill 2017.
- 109 Të dhëna të pabotuara nga PAX, CPT, Impunity Watch dhe Integra, 'Perceptimi publik i Gjykatës Speciale të Kosovës', Prishtinë, prill 2017, f. 1.
- 110 Lëvizja Vetëvendosje, 'Gjykata Speciale minon shtetin e së drejtës në Kosovë dhe e sulmon moralisht luftën tonë çlirimtare'. 19 shkurt 2015. <https://www.youtube.com/watch?v=116IMV7NGgQ>.
- 111 Ibid.
- 112 Të dhëna të pabotuara nga PAX, CPT, Impunity Watch dhe Integra, 'Perceptimi publik i Gjykatës Speciale të Kosovës', Prishtinë, prill 2017.
- 113 Gazeta Express, 'Nysrete Kumnova: Serbia po luan me ndjenjat e familjarëve të të zhdukurve', 25 tetor 2016. Mund të gjendet në: <http://www.gazetaexpress.com/lajme/nysrete-kumnova-serbia-po-luan-me-ndjenjat-e-familjareve-te-te-zhdukurve-270112?archive=1> (Data e qasjes: 21 maj 2017).
- 114 Intervistë personale me një ekspert të drejtësisë tranzicionale në Kosovë, Prishtinë, 25 prill 2017.

- 115 Intervistë personale me një aktivist të shoqërisë civile serbe të Kosovës, Mitrovica Veriore, 27 prill 2017.
- 116 Të dhëna të pabotuara nga PAX, CPT, Impunity Watch dhe Integra, 'Perceptimi publik i Gjykatës Speciale të Kosovës', Prishtinë, prill 2017, f. 1.
- 117 Koment nga një aktivist i shoqërisë civile serbe të Kosovës, Prishtinë, 12 qershor 2017.
- 118 Diskutime me Fokus-grupin me pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, prill-maj 2017.
- 119 UNDP, 'Perceptimet mbi Drejtësinë Tranzicionale', Prishtinë, 2012. Mund të gjendet: [http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/TJ/English-Web\\_965257.pdf](http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/TJ/English-Web_965257.pdf) (Data e qasjes: 20 maj 2017).
- 120 Intervistë personale me një aktivist të shoqërisë civile serbe të Kosovës, Prishtinë, 28 prill 2017.
- 121 Intervistë personale me një këshilltar ligjor në një ambasadë të huaj në Kosovë, Prishtinë, 2 maj 2017.
- 122 Intervistë personale me një aktivist të shoqërisë civile shqiptare të Kosovës, Prishtinë, 28 prill 2017.
- 123 Ibid.
- 124 Ibid.
- 125 Intervistë personale me një këshilltar ligjor në një ambasadë të huaj në Kosovë, Prishtinë, 2 maj 2017.
- 126 Të dhëna të pabotuara nga PAX, CPT, Impunity Watch dhe Integra, 'Perceptimi publik i Gjykatës Speciale të Kosovës', Prishtinë, prill 2017, f. 1.
- 127 Intervistë personale me një ekspert shqiptar të Kosovës, Prishtinë, 25 prill 2017.
- 128 Intervistë personale me një ish-këshilltar politik, Prishtinë, 2 maj 2017.
- 129 Intervistë personale me një këshilltar ligjor të qeverisë së Kosovës, Prishtinë, 24 prill 2017.
- 130 Të dhëna të pabotuara nga PAX, CPT, Impunity Watch dhe Integra, 'Perceptimi publik i Gjykatës Speciale të Kosovës', Prishtinë, prill 2017, f. 1.
- 131 Shih, për shembull, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese në Kosovë: <http://birn.eu.com/en/network/birn-kosovo-home>.
- 132 Shih, për shembull, Raportimi i mediave për përdhunimin gjatë luftës në Kosovë: Serbeze Haxhiaj, 'Agonia e përhershme e përdhunimeve gjatë kohës së luftës në Kosovë', BIRN, 29 maj 2017. Mund të gjendet në: <http://www.balkaninsight.com/en/article/agonia-of-war-time-rape-victims-endures-in-kosovo-05-28-2017-1> (Data e qasjes: 29 Maj 2017).
- 133 Për një pasqyrë më gjithëpërfshirëse, shikoni dokumentacionin e procedurave në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës: <http://www.presscouncil-ks.org/>. Shih po ashtu, Komisioni i Pavarur për Media: <http://www.kpm-ks.org/?gjuha=3>. Shih po ashtu: Una Hajdari, 'Vëzhguesi i Kosovës dënon kërcënimin ndaj gazetarit', BIRN, 9 July 2015. Mund të gjendet në: <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-journalism-watchdog-condemns-veterans-threat-to-journalist> (Data e qasjes: 23 prill 2017).
- 134 Intervistë personale me një aktivist të shoqërisë civile serbe të Kosovës, Mitrovica Veriore, 27 prill 2017.
- 135 Intervistë personale me një këshilltar të lartë të qeverisë së Kosovës, Prishtinë, 25 prill 2017.
- 136 Tanjug, 'Analiza ditore e MPJ-së serbe: Beogradi nuk beson në qëllimin e sinqertë të Prishtinës', Beograd, 10 gusht 2015. Mund të gjendet në: <http://www.mfa.gov.rs/en/component/content/article/64-daily-survey/14534-daily-survey-10082015> (Data e qasjes: 18 prill 2017).
- 137 Për një analizë më të detajuar, shih Gëzim Visoka, *Formësimi i Paqes në Kosovë: Politika e Ndërtimit të Paqes dhe Shtetësisë*, Basingstoke: Palgrave Macmillan, 2017.
- 138 Intervistë personale me një zyrtar të BE, Bruksel, 15 prill 2017.
- 139 Intervistë personale me një diplomat të huaj, Prishtinë, 26 prill 2017.
- 140 Për më shumë detaje, shih Gëzim Visoka dhe Oliver P. Richmond, 'Pas Paqes Liberale: Nga Ndërtimi i Shtetit të Dështuar tek Paqja Emancipuese në Kosovë', *Perspektivat e Studimeve Ndërkombëtare*, Vëll. 18, Nr. 1, 2017, ff. 110-129.
- 141 Për një diskutim më të gjerë, shih Catherine Baker dhe Jelena Obradovic-Wochnik, 'Hartimi i Lidhjes së Drejtësisë Tranzicionale dhe Ndërtimit të Paqes', *Zhurnali i Ndërhyrjes dhe Shtetndërtimit*, Vëll. 10, Nr. 3, 2016, ff. 281-301. Shih gjithashtu Denisa Kostovicova, 'Freskimi i krimeve, marginalizimi i viktimave: pritjet politike dhe drejtësia tranzicionale në Kosovë', në: Timothy William Waters, (ed) *Gjykimi i Milosheviqit: Një Autopsi*. New York: Oxford University Press, 2014, ff. 249-259.
- 142 Intervistë personale me një aktivist të shoqërisë civile serbe të Kosovës, Mitrovica Veriore, 27 prill 2017.
- 143 Presidenti i Kosovës, 'Draft Rregullorja për Komisionin për të Vërtetën dhe Pajtimin', Prishtinë, 20 prill 2017.
- 144 Shih Nora Ahmetaj dhe Thomas Unger, 'Korniza e Kosovës për t'u ballafaquar me të kaluarën në një pikë kthese' Shqyrtimi i progresit të shoqërisë civile drejt një Strategjie Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale', Impunity Watch, CPT, Integra dhe PAX, Prishtinë, prill 2017. Mund të gjendet në: [http://www.impunitywatch.org/docs/Civil\\_society\\_review\\_report\\_final\\_ENG\\_8.51.pdf](http://www.impunitywatch.org/docs/Civil_society_review_report_final_ENG_8.51.pdf) (data e qasjes: 23 qershor 2017).
- 145 Për një diskutim më të gjerë, shih Impunity Watch, 'Veprimi për të luftuar mosndëshkimin në Serbi: Opcionet dhe pengesat', Utrecht, 2008. Mund të gjendet në: [http://www.impunitywatch.org/docs/BCR\\_Serbia-Summary\\_Report\\_English.pdf](http://www.impunitywatch.org/docs/BCR_Serbia-Summary_Report_English.pdf) (Data e qasjes: 23 qershor 2017).
- 146 Impunity Watch, 'Udhëzime Politikash: Rritja e Ndikimit Shoqëror të Tribunalit Ndërkombëtar Penal', Utrecht, shkurt 2015, p. 4. Mund të gjendet në: [http://www.impunitywatch.org/docs/Policy\\_Brief\\_-\\_Enhancing\\_the\\_Societal\\_Impact\\_of\\_International\\_Criminal\\_Tribunals.pdf](http://www.impunitywatch.org/docs/Policy_Brief_-_Enhancing_the_Societal_Impact_of_International_Criminal_Tribunals.pdf) (data e qasjes: 19 qershor 2017).
- 147 Të dhëna të pabotuara nga PAX, CPT, Impunity Watch dhe Integra, 'Perceptimi publik i Gjykatës Speciale të Kosovës', Prishtinë, prill 2017, f. 1.

- 148 Intervistë personale me një këshilltar ligjor në një ambasadë të huaj në Kosovë, Prishtinë, 2 maj 2017.
- 149 Shih Janine Natalya Clark, 'Tribunalet Ndërkombëtare të Krimeve të Luftës dhe Sfida e Shpërndarjes', *Rishikimi i Ligjit Ndërkombëtar Kriminal*, , Vëll. 9, Nr. 1, 2009, ff. 99-116.
- 150 Intervistë personale me një ekspert të drejtësisë tranzicionale, Prishtinë, 25 prill 2017.
- 151 Intervistë personale me një aktivist të shoqërisë civile shqiptare të Kosovës, Prishtinë, 4 maj 2017.
- 152 Shih Matthew E. Cross, 'Përgatitja e Dhomave Speciale të Kosovës për të gjykuar krimet ndërnacionale: Vërejtje mbi pavarësinë dhe bashkëpunimin', *Zhumali i Drejtësisë Ndërkombëtare Kriminale*, Vëll. 14, Nr. 1, 2016, ff. 73-100.
- 153 Intervistë personale me një zyrtar të EEAS, Bruksel, 16 maj 2017. Për një perspektivë pak më ndryshe, shih Emanuele Cimiotta, 'Dhomat Speciale dhe Prokuroria Speciale në Kosovë: 'Regionalizimi' i Drejtësisë Penale në kontekst', *Zhumali i Drejtësisë Ndërkombëtare Kriminale*, Vëll. 14, Nr. 1, 2016, ff. 53-72.
- 154 'Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) në mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës', 27 tetor 2015, Neni 3.
- 155 Sarah Williams, 'Dhoma Speciale e Kosovës: Limitet e Ndërkombëtarizimit', *Zhumali i Drejtësisë Ndërkombëtare Kriminale*, Vëll. 14, Nr. 1, 2016, f.48.
- 156 Intervistë personale me një diplomat të huaj, Prishtinë, 26 prill 2017.
- 157 Intervistë personale me një ekspert të drejtësisë tranzicionale, Prishtinë, 25 prill 2017.
- 158 Intervistë personale me një oficer të EEAS, Bruksel, 16 maj 2017.
- 159 Intervistë personale me një zyrtar të Komisionit Evropian, Bruksel, 15 maj 2017.
- 160 Shih EEAS, 'Korniza e Politikave të BE-së mbi Mbështetjen e Drejtësisë Tranzicionale ', Bruksel, nëntor 2015.
- 161 Shih Nora Ahmetaj dhe Thomas Unger, 'Korniza e Kosovës për ballafaqim me të kaluarën në një pikë kthese" Shqyrtimi i progresit të shoqërisë civile drejt një Strategjie Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale', Impunity Watch, CPT, Integra dhe PAX, Prishtinë, prill 2017. Mund të gjendet në: [http://www.impunitywatch.org/docs/Civil\\_society\\_review\\_report\\_final\\_ENG\\_8.51.pdf](http://www.impunitywatch.org/docs/Civil_society_review_report_final_ENG_8.51.pdf) (data e qasjes: 23 qershor 2017).
- 162 Disa nga iniciativat e suksesshme në Kosovë përfshijnë 'Librin e Kujtesës të Kosovës' (Qendra për të Drejtën Humanitare), 'Dua të dëgjohem' dhe 'Njerëzit dhe kujtimet flasin' (Integra) dhe Projekti 'Historia Orale e Kosovës'.
- 163 Për më shumë detaje, shih Statuti i Zyrës Regjionale për Bashkëpunim të Rinisë: [https://rycoblog.files.wordpress.com/2016/07/ryco-statute\\_\\_final.pdf](https://rycoblog.files.wordpress.com/2016/07/ryco-statute__final.pdf).









**Për pyetje ose informata shtesë, ju lutem kontaktoni:**

Michael James Warren, Menaxher Programi

PAX (Holandë)

[www.paxforpeace.nl](http://www.paxforpeace.nl) | [warren@paxforpeace.nl](mailto:warren@paxforpeace.nl)

Marlies Stappers, Drejtor Ekzekutiv

Impunity Watch (Holandë)

[www.impunitywatch.org](http://www.impunitywatch.org) | [marlies.stappers@impunitywatch.org](mailto:marlies.stappers@impunitywatch.org)



Joseph Haydnlaan 2a  
3533 AE Utrecht  
The Netherlands

[www.impunitywatch.org](http://www.impunitywatch.org)  
[info@impunitywatch.org](mailto:info@impunitywatch.org)

+31 30 307 22 80  
P.O. Box 43015  
3540 AA Utrecht  
The Netherlands



Sint Jacobsstraat 12  
3511 BS Utrecht  
The Netherlands

[www.paxforpeace.nl](http://www.paxforpeace.nl)  
[info@paxforpeace.nl](mailto:info@paxforpeace.nl)

+31 (0)30 233 33 46  
P.O. Box 19318  
3501 DH Utrecht  
The Netherlands

